

Analistët
Shqiptarët
heshtin për
emrin e shtetit

Fq.3



**KOMUNA
E TETOVËS**
Mbi 50 kazino
dhe dyfish më
shumë bastore

Fq.7



La kryt
pas fem-
nave!
**Adelina
Marku**

Fq.10



Koha

www.koha.mk



**Siria dhe
7 vjet
luftë**

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3354 · e mërkurë 2 maj, 2018

14°C | 28°C

15 DEN

EDITORIAL

Si ta
de-getoizojmë
Çairin?



Dikur zezakët e Bronxit në New York ishin të "privilegjuar" të merreshin vetëm me aktivitete delikuede e asociale, mirëpo kokat e zgjuara të këtij komuniteti punuan me dekada e dekada për ta de-getoizuar Nju Jorkun dhe tani ke artistë të shquar nga Bronxi që rrezatojnë vlera, duke performuar në Manhattan, në Broadway, por edhe ...

Fq.2

MOZAIK

Romanca
që tronditi
Evropën

Fq.13

RAJON

Rama: S'ka
rrezik nga
Turqia

Fq.14

MOZAIK

Jeta e vetme
e gruas së
Stiv Jobs

Fq.13



LARG STANDARDEVE EVROPIANE EDHE SIPAS NUMRAVE

SHUMË UNIVERSITETE, PAK CILËSI



Me 23 institucione të arsimit të lartë, në një shtet me 2 milionë banorë dhe jo më shumë se 36 mijë metra katrorë, na kanë larguar shumë nga standardet evropiane si për nga cilësia, ashtu edhe të krahasuar numerikisht. Sipas kriterëve që përdoren në Evropë, ka një universitet publik për 600.000-700.000 banorë. Pra, i bie që në Maqedoni të ishin realisht tre universitete publike, por assesi gjashtë

Fq.6

I sëmurë në Ballkan, paratë në dorë ose prit!

Shkup, 1 maj - "Këtë mund ta zgjidhim privatisht". Kjo fjali magjike dëgjohej rregullisht në Ballkan, edhe Natasha e dëgjoji, kur donte të mbyllte një orar për kontroll në spital. 30 vjeçarja nga Novi Sadi sapo ka lënë pas vuajtjet e një tumori në sistemin limfatik dhe nuk do të humbasë kohë. Por ajo nuk ka para për të paguar "privatisht", jashtë sistemit të siguracionit shëndetësor shtetëror vizitën mjekësore. Shu-

mica e pacientëve në vendet e Ballkanit që përbënin dikur Jugosllavinë socialiste janë të varur nga sistemi shëndetësor shtetëror. Për qytetarët në Serbi, Maqedoni apo Bosnje, ku rroga mesatare është rreth 400 euro neto dhe papunësia kalon 20%, kontrollet private tek mjeku janë një luks i paarritshëm. Këtë hap pacientët e ndërmarrin vetëm në rast nevojë, kur pritja e gjatë kthehet...

Fq.9



EDITORIAL

SI TA DE-GETOIZOJMË ÇAIRIN?



Emin AZEMI

Në një mori asimetrish që karakterizojnë Shkupin, ndodhet edhe apatia e organizimit të jetës kulturore. Në Shkupin urban lulëzon kultura "mondane", ndërkohë që në Shkupin paraurban lulëzon "kultura" e kazinove, e parqeve të uzurpuara me ndërtime të egra dhe e trotuareve të stërngarkuara me makina që pengojnë qarkullimin e lirshëm të këmbësorëve. Çairi llogaritet si Komunë e ashtuquajtur urbane e Shkupit. Mirëpo se çka ka urbane në të lë shumë çka për të dëshiruar, për arsye se njerëzit e kësaj komune që merren me kulturë, të gjitha aktivitetet kulturore i organizojnë në pjesën "mondane" të Shkupit dhe pak diçka edhe në pjesën e Vjetër, aty ku Çarshia e Shkupit është shndërruar në një çervish bakalhaneje, tregtie, zejtarie, hoteleriko-turistike, e fare pak kulturore e artistike.

Në Çair ka shkolla fillore e të mesme, mirëpo nxënësit, arsimtarët dhe pak prindër janë të detyruar ta kalojnë Vardarin për të shkuar në kinema, ose në ndonjë shfaqje teatri. Fëmijët në Çair nuk mund të shkojnë as në cirk. Në Çair nuk vijnë yjet e muzikës klasike, sepse nuk ka një vend-arenë ku do të organizohet spektakli. Në Çair nuk organizohet ndonjë festival i recituesve të rinj, sepse aty parqet po betonohen me ndërtime pa kriter, dhe për rrjedhojë nuk ka një Shtëpi Kulture, e cila do ta absorbonte kapacitetet krijuese e kreative të kësaj pjese të Shkupit.

Ato pak promovime librash që i kemi, çuditërisht organizohen në hapësirat e Komunës së Çairit dhe ata që e bëjnë këtë gabojnë shumë kur ngushëllohen me efektin që krijon kompensimi i diçkasë me asgjë. "Iz šupljeg u prazno" do të thoshin kroatët, ndërkaq të gjithë ata që i kanë për zemër improvizimet, iu duket se edhe një hapësirë e zbrazët është interesante, mjafton të jetë ai/ata aty. Por nuk bën pa e thënë se hapësirat e institucionit që quhet Komunë, kanë një atribut tjetër nga ajo çka konsiderohet kulturë, kurse paragjykesit (që nuk janë pak) janë të prirur ta lidhin komunën (drejtuesit e saj) me ndonjë person që organizon promovime librash dhe ka jo pak individë, dashamirë të librit që pikërisht nga ky shkak nuk marrin pjesë në promovime të tilla. Jo se vërtetë paragjykesit kanë të drejtë në atë që e insinuojnë, por, dorën në zemër, nëpër hapësira komunash gjithkund në botë, organizohen vetëm mbledhjet e asambleve komunale, ndonjë veprimtari që ndër lidhet me sektorët e komunës, por në asnjë mënyrë aktivitetet me attribute kulturore-krijuese. Atje (në botën e qytetëruar), koncertet, recitalet, shfaqjet skenike organizohen nëpër qendra kulturore (madje edhe nëpër mini-bashki) të cilat thithin talentë nga komuniteti që i rrethon dhe gjithë ky menaxhim kulturor krijon një rrezatim shumë të vlefshëm, një rrezatim që drejtpërdrejt ndikon në formimin kulturor, qytetar, social të gjeneratave të reja, të cilët nesër janë shtresa e emancipuar e shoqërisë.

Si do ta emancipojmë komunitetin e Çairit nëse vazhdojmë ta ndajmë si me thikë Shkupin "mondan" dhe Shkupin "paraurban"? Janë disa individë nga Çairi që bajnë gajle shumë për jetën kulturore në qendër të Shkupit, ndërkohë që nuk kanë organizu as edhe një aktivitet të vockël në ndonjë lagje të Tophanes, Butelit, Çairit, Gazi Babës, Cerovës, Dizhonit etj.

ku do të ndikonin drejtpërdrejt në emancipimin kulturor të fëmijëve të këtyre lagjeve. A e kanë menduar këta individë se sa publik nga ky Shkupi "paraurban" shkon në aktivitete kulturore që organizohen në qendër të Shkupit urban, ose në Çarshinë e Vjetër? A e dinë ata se në aktivitetet që organizojnë, shkon një publik "aksidental", çallëmgjinjë që merr pjesë vetëm në premiera ku biletat janë gratis dhe ku reprizat e shfaqjeve ndiqen nga një grup i vogël entuziastësh fanatik, një publik burrash snobistë të shoqëruar me gra kompleksive që spektaklet e tilla i shfrytëzojnë për sfilata dhe reklama fustanesh e xhingla-mingla aksesorësh? Po ti pyetni ato gra se si quhet shfaqja, kush është autori e kush regjisori, do të "grushtoheni" nga një mosdije injorante që do t'iu përplaset në fytyrën tuaj naive, për faktin se guxonit të shtroni pyetje të tilla aq "delikate".

Buxhetet që ndahen për aktivitete kulturore, qoftë nga Ministria e Kulturës, Qyteti i Shkupit, qoftë nga Komuna e Çairit, është mirë të menaxhohen më ndryshe dhe të krijohet një strategji që do të ishte përfituese për publikun e komunitetit që jeton në territorin e komunës së Çairit. Ne nuk kemi nevojë për publik snobistësh dhe çallëmxhjinjesh bashkë me gratë e tyre "maqingjike", por kemi nevojë për publik të shkollave fillore e të mesme, bashkë me prindërit e tyre, sepse ata nesër do të jenë bartësit kryesor të emancipimit kulturor të kësaj popullate që është e dënuar të jetojë nëpër "getot" e Çairit. Dikur zezakët e Bronxit në New York ishin të "privilegjuar" të merreshin vetëm me aktivitete delikuede e asociiale, mirëpo kokat e zgjuara të këtij komuniteti punuan me dekada e dekada për ta de-getoizuar Nju Jorkun dhe tani ke artistë të shquar nga Bronksi që rrezatojnë vlera, duke performuar në Manhattan, në Broadway, por edhe në Hollywood e qendra të tjera artistike e kulturore.

Në Çair nuk ke nevojë të jesh zezak për të pësuar transformim social-kulturor. Në Çair, zezak mund të bëhesh edhe pa e imituar Bronxin e New Yorkut, por nuk mundesh të bëhesh publik i kultivuar nëse në krye të organizimeve publike-artistike ke njerëz që nuk mësojnë nga modelet botërore të menaxhimit kulturor. "Manhattani" i Shkupit nuk ka nevojë për "pangjyret" tona kinse-kulturore, me çka nxjerrim në treg mungesën e madhe të sensit tonë për të detektuar nevojat e ngutshme që lidhen me edukimin estetik të komunitetit të nxënësve, arsimtarëve, studentëve, prindërve dhe intelektualëve të papunë të Çairit.

Të detektosh një problem dhe të punosh për ta zgjidhur atë problem, sot është vlera kulmore e patriotizmit qytetar, kurse gjithë ata që bëjnë sehir dhe bëhen sikur janë të brengosur për problemin që i mundon, sot i ke pjesëtar të publikut çallëmgjinjë që shfrytëzon bileta gratis për të pa ndonjë shfaqje që nuk ia di as emrin në pjesën "mondane" të Shkupit, paçka se fëmijët e "getove" të Çairit po i ushqejnë "mushkëritë estetike" me pluhurin e injorancës sonë me dimensione alarmante alergjike. Ka rrezik që kjo alergji një ditë të merr përmasat e një përbindëshi të uritur, i cili ardhmërinë e gjithë neve do ta përdorë si "taxhi" nga ujemi i pakujdesive tona sistematike.

KA PIKËPAMJE TË NDRYSHME PËR 1 MAJIN

"Çdo punëtor në Kosovë, sot vlerësohet më shumë se në të kaluarën. I kemi rritur disa herë pagat dhe tash ato janë pothuajse në nivel të barabartë me vendet e rajonit.

Kemi hartuar ligje moderne që mbrojnë të drejtat e punëtorëve, por kërkohet një zbatim dhe monitorim më i mirë i tyre. Varësisht prej vendeve dhe kulturave të tyre, ka pikëpamje të ndryshme për 1 Majin, por kjo ditë gjithmonë është festuar te ne.

Duke ua uruar të gjithëve festën, unë ndaj shqetësimin me të gjithë punëtorët, si të sektorit publik, ashtu edhe të atij privat, si dhe u bashkohem kërkesave të tyre për kushte më të mira të punës dhe të drejta më shumë për punëtorët. Si shtet i ri duhet të kemi një përkujdesje më dinjitoze për të gjitha kategoritë shoqërore, ku shtylla më e fortë e ekonomisë dhe Republikës sonë padyshim se janë të gjithë punëtorët", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

DITË HISTORIKE PËR JAHUDITË, E ZEZË PËR PALESTINEZËT...!!

"Parlamenti izraelit (Kneset) dje që në rundin e parë ka votuar ligjin që e njeh Izraelin shtet vetëm i jahudive ndërsa Kudsi Sherifin kryeqytet i vetëm atyre.

Ligji parasheh që tani e tutje elemente nga historia jehudite do të jenë pjesë e ceremonive të shtetit, ndërsa gjuhën arabe e shndërron nga gjuha zyrtare në gjuhë me status të veçantë në zonat ku jetojnë palestinezët.

Sipas këtij ligji Izraeli shpallet "shtëpi e jahudive" dhe se vetëm jahuditë kanë të drejtë të kthehen atje për të jetuar.

Ligji në fjalë i jep Izraelit të drejtën jehudizimit absolut të shtetit dhe cenon deri në ekstrem identitetin arab dhe islam të tokave të atjeshme. Ligjin e kanë votuar 64 deputetë, ndërsa vetëm 5 e kanë kundërshtuar ...!", shkruan teologu Mustafë Bajrami në profilin e tij në Facebook.

SI LINDI 1 MAJI?

Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve, në shumë vende shoqërohet me protesta të lëvizjeve sindakale që luftojnë për të drejtat e punëtorëve. 1 maji lindi si rrjedhojë e protestave të punëtorëve që kërkonin rritjen e të drejtave të tyre në lidhje me orarin e punës, që duhet të ishte 8 orë. Falë protestave u arrit që më 1866 në Illinois të SHBA-ve të miratohej ligji që u njihte punëtorëve të drejtat e tyre. Origjina e kësaj feste daton nga manifestimi i organizuar në Shtetet e Bashkuara nga Kalorësit e Punës (Knights of Labor), një shoqatë e themeluar në 1869 në Nju Jork, 5 shtator 1882. Nga viti 1890 në Paris, Kongresi themelues i Internacionales së dytë, vendosi që pikërisht 1 Maji të mbetet Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve. Nga viti 1891, Kongresi i tretë i Internacionales në Bruksel, mori vendim, që: dita e 1 Majit do të kremtohet përgjithmonë dhe në të gjitha vendet, si Festa e Punëtorëve, në të cilën punëtorët do t'i identifikojnë, avancojnë dhe mbrojnë me Kushtetutë e ligje, liritë, të drejtat, kushtet e punës, rrogën mesatare të garantuar, pushimin ditor, javor, vjetor dhe pushimet tjera sipas nevojës.



NËSE NUK
E KENI DITUR...

BISEDIMET RRETH EMRIT NË FAZËN MË SENSITIVE

SHQIPTARËT HESHTIN PËR EMRIN E SHTETIT

Në gjithë këtë proces nuk mund të mos vërehet heshtja totale e faktorit politik shqiptarë që të flet me një zë karshi bisedimeve direkte për zgjidhjen e çështjes së emrit, thonë analistët. Emri që po flitet në qarqe politike dhe në media - "Gornamakedonija", nuk ka ndonjë qëndrim të qartë për faktorit politik shqiptarë nëse është përjashtues ndaj etnitet shqiptar, sidomos kur duket se të gjithë po synojnë barazinë e shqiptarëve me maqedonasit



shqiptar në Maqedoni kur duket se të gjithë synojnë barazinë e shqiptarëve me maqedonasit. Analisti politik Ibrahim Mehmeti mendon se është jo produktive qëndrimi anash i faktorit politik shqiptarë. "Sa i përket bisedimeve rreth çështjes së emrit, mendoj se tani që afrohet data e përmbylljes, del se çështjet kryesore dhe më sensitive në fakt kanë mbetur pa u shtjelluar, andaj kemi edhe tone jo aq optimiste. S'do mend se Greqia është palë negociuese me shumë eksperiencë diplomatike dhe të gjithë ata në Maqedoni që mendonin se gjithçka do të shkojë lehtë, padyshim se do të zhgënjehen. Nga ana tjetër, është joproduktive që faktori politik shqiptarë qëndron anash në këtë proces, sepse mund të ndodhë që të kemi rezultat, i cili do të ishte problematik për shqiptarët", thekson Ibrahim Mehmeti. Ai ka shpresë se kryeministri Zaev është i vendosur të gjendet një zgjidhje, por çështja është, siç thotë ai, a do të ishte e pranueshme për shqiptarët që janë pjesë aktive e vendimmarrjes politike.

"Sidoqoftë, vendosmëria e kryeministrit megjithatë tregon shpresa se mund të kemi zgjidhje, e cila do ta mundësonte anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, por sërish mbetet të shihet se cila është kjo zgjidhje dhe sa ajo do të ishte e pranueshme edhe për komunitetet që nuk janë shumicë, e para se gjithash për shqiptarët, të cilët janë pjesë aktive në vendimmarrje. Ndoshta do të kishite qenë e udhës që politikanët shqiptarë të konsultohen me njerëz të

shkencës që të kenë qëndrim më të qëndrueshëm kur të vijë në rend dite përmbyllja e kësaj çështjeje", thotë Ibrahim Mehmeti.

Profesori universitar, Bashkim Selmani, mendon se pavarësisht faktit nëse Greqia do të lëshojë pe apo jo në rrafshin politik të zgjidhjes së çështjes së emrit, shqiptarët në këtë mes, sipas tij, janë të anashkalluar dhe më të dëmtuar. "E para është çështja politike në nivel ndërkombëtarë. Edhe pse duket afër zgjidhja, realisht është komplekse në të cilin rast palët bashkëbiseduese gjejnë vakum kohor në çështjen juridike dhe atë kushtetuese për të mos zgjidhur kontestin politik. E dyta është Greqia ajo që kushtëzon dhe siç duket - nuk është e gatshme për të bërë zgjidhjen e duhur për sa i përket këndvështrimit politik. Por, edhe sikur të ketë apo mos të ketë zgjidhje për çështjen faktike - shqiptarët në këtë mes janë më të anashkalluar dhe më të dëmtuar", thekson Selmani. Ai thotë se pa zgjidhje politike nuk mund të ketë kompromis juridiko-kushtetues.

"Çështja juridiko-kushtetuese për këtë periudhë kohore duke u bazuar në numrin e votave të Parlamentit realisht është diskutabile. Prandaj të dyja këto çështje janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe pa zgjidhjen politike nuk mund të ketë as kompromis juridiko-kushtetues, edhe pse faktori ndërkombëtarë po bën presione ndaj palës greke, e cila gjithmonë ka fituar nga fqinjët e saj", thotë Selmani. Lideri i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela

ndërkohë vë në dilemë angazhimin e partisë shqiptare në pushtet - BDI, në zgjidhjen e çështjes së emrit duke qenë kritik ndaj liderit të saj, Ali Ahmeti se nuk thërret tryezë të rrumbullakët për të unifikuar qëndrimin e faktorit politik shqiptar rreth çështjes së emrit. "Ne kemi përfaqësues legjitim në Qeveri, të cilët nuk e dimë nëse janë të kyçur direkt apo jo në zgjidhjen e çështjes së emrit. Ne kishim një Deklaratë politike të nënshkruar nga subjektet politike parlamentare dhe njëra ndër pikat e saj ishte unifikimi i qëndrimeve për tema të rëndësishme që prekin edhe interesin tonë si shqiptarë, edhe atë përmes organizimit të tryezave të përbashkëta gjë që nuk po ndodh tashmë një kohë të gjatë. Si lider i ASH-së i kam bërë thirrje publike liderit të BDI-së, Ali Ahmeti, që për çështjen e emrit - të mbledhemi në një tryezë të përbashkët për të dalë më një qëndrim. Kjo, sepse emrin nuk e kemi gurë të hedhur, por e kemi gurë të mbirë. Fatkeqësisht, kjo nuk ka ndodhur", tha Sela. Ai është kategorik ndaj emrit vetëm me elementin sllav pa përkthim, siç flitet për emrin "Gornamakedonija".

"Nuk ka asgjë të keqe që në emrin e një shteti të kemi ndonjë përcaktim gjeografik. Por ne jemi kundër asaj që emri i shtetit të sllavizohet, këtë nuk duhet lejuar, sepse ndryshe është të mbetet vetëm Gornamakedonia e ndryshe të lejohet me përkthim 'Maqedonia e Veriut' dhe që mund të jetë i pranueshëm për ne", thotë Sela. Për të dhe partinë e tij ajo që duhet të shqetësojë shqiptarët është anashkallimi i gjuhës shqipe në bisedimet rreth emrit, ndërsa shton se ASH deri në fund do të insistojë që gjuha shqipe në OKB të jetë e barabartë me gjuhën maqedonase.

"Ajo që duhet të na shqetësojë neve është pozita e gjuhës shqipe në gjithë këtë proces deri në zgjidhjen e tij. Neve nuk na intereson nëse me Greqinë merren vesh për gjuhën maqedonase, por si do të përfshihet edhe gjuha shqipe. Ne si

IBRAHIM MEHMETI

Vendosmëria e kryeministrit megjithatë tregon shpresa se mund të kemi zgjidhje, e cila do ta mundësonte anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, por sërish mbetet të shihet se cila është kjo zgjidhje dhe sa ajo do të ishte e pranueshme edhe për komunitetet që nuk janë shumicë, e para se gjithash për shqiptarët, të cilët janë pjesë aktive në vendimmarrje. Ndoshta do të kishite qenë e udhës që politikanët shqiptarë të konsultohen me njerëz të shkencës që të kenë qëndrim më të qëndrueshëm kur të vijë në rend dite përmbyllja e kësaj çështjeje

BASHKIM SELMANI

Edhe pse duket afër zgjidhja, realisht është komplekse në të cilin rast palët bashkëbiseduese gjejnë vakum kohor në çështjen juridike dhe atë kushtetuese për të mos zgjidhur kontestin politik. E dyta është Greqia ajo që kushtëzon dhe siç duket - nuk është e gatshme për të bërë zgjidhjen e duhur për sa i përket këndvështrimit politik. Por, edhe sikur të ketë apo mos të ketë zgjidhje për çështjen faktike - shqiptarët në këtë mes janë më të anashkalluar dhe më të dëmtuar

ZIADIN SELA

Ne kemi përfaqësues legjitim në Qeveri, të cilët nuk e dimë nëse janë të kyçur direkt apo jo në zgjidhjen e çështjes së emrit. Ne kishim një Deklaratë politike të nënshkruar nga subjektet politike parlamentare dhe njëra ndër pikat e saj ishte unifikimi i qëndrimeve për tema të rëndësishme që prekin edhe interesin tonë si shqiptarë, edhe atë përmes organizimit të tryezave të përbashkëta gjë që nuk po ndodh tashmë një kohë të gjatë

Aleancë për Shqiptarët do të insistojmë deri në fund që gjuha shqipe të përfshihet në OKB krahas gjuhës maqedonase. Ndryshe, çfarë kuptimi do të ketë sjellja e ligjit për gjuhët për të cilin bëjmë shumë sakrificë", theksoi lideri i ASH-së, Ziadin Sela.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 1 maj - Bisedimet për zgjidhjen e çështjes së emrit mes Qeverisë greke dhe asaj maqedonase janë në fazën më sensitive kur tashmë duhet të vendoset diçka para Samitit të NATO-s që do të mbahet në muajin korrik në Strasburg të Francës. Kryeministri Zoran Zaev së fundmi përmendi edhe ndryshimet kushtetuese si të mundshme, por duke i lidhur ato me kohën kur sovraniteti i shtetit të bartet tek Bashkimi Evropian. "Ndoshta zgjidhja përfundimtare do të jetë e lidhur me votimin e qytetarëve Maqedonisë, duke i dhënë sovranitetin tonë Bashkimit Evropian, ku dëshirojmë të anëtarësohemi dhe atëherë hapet edhe Kushtetuta. Ndoshta këtu është zgjidhja, për shkak se siç e dini, Greqia kërkon edhe ndryshimin e Kushtetutës për ndryshimin e emrit kushtetues... Zoran Zaevi dhe Aleksis Cipras mund t'i shtrijnë duart dhe të arrijnë marrëveshje, por institucionet janë ato, të cilat e nxjerrin qëndrimin përfundimtar, sikur edhe qytetarët e të dy vendeve", theksoi Zaev për Radion Evropa e Lirë. Por në gjithë këtë proces nuk mund të mos vërehet heshtja totale e faktorit politik shqiptarë që të flet me një zë karshi bisedimeve direkte për zgjidhjen e çështjes së emrit. Ndërkaq emri që po flitet në qarqe politike dhe në media "Gornamakedonija", nuk ka ndonjë qëndrim të qartë të faktorit politik shqiptarë nëse është përjashtues ndaj etnitet

MEDIAT GREKE PËR DEKLARATËN E ZAEVIT

"Zaev: I mundshëm ndryshimi i Kushtetutës për integrim në BE", "Zaev: Me siguri do ta hapim Kushtetutën në prag të integritimit në BE", "E hapur mundësia për rishikim të Kushtetutës të IRJM", "Zaev nuk e përjashton mundësinë për rishikim të Kushtetutës", janë një pjesë e titujve në mediat greke për deklaratën e djeshme të Kryeministrit të Maqedonisë lidhur me mundësinë të bëhen ndryshime kushtetuese te ne". "IRJM me siguri do të duhet ta hap çështjen me kushtetutën e saj, para integritimit në BE, si të gjitha anëtarët e Unionit", deklaroi Kryeministri i IRJM, Zoran Zaev, shkruan

"Katimerini". "TV Skaj" grek, në faqen e tij zyrtare, megjithatë, shkruan se "Kryeministri i Shkupit Zoran Zaev e ka lënë të hapur mundësinë për rishikimin e Kushtetutës të vendit". Siç njoftoi korrespondentja e MIA-s nga Athina, mediat greke e transmetojnë edhe qëndrimin e Kryeministrit të Maqedonisë lidhur me atë se zgjidhjen do ta caktojë institucionet, e jo personalisht ai apo Ciprasi, por, nuk e transmeton pjesën në të cilën Zaevi përgjigjet negativisht në pyetjen nëse ndryshimet kushtetuese kanë të bëjnë me ndryshimin e emrit kushtetues.

SHEKERINSKA
NË VERMONTMaqedonia
meriton
anëtarësim
në NATO

Shkup, 1 maj - Ministrja e Mbrojtjes, Radmila Shekerinska konsideron se Maqedonia e meriton anëtarësimin në NATO me përkushtimin e punën e saj, si dhe se ftesa nga Aleanca do të kontribuonte jo vetëm për stabilitetin e vendit, por edhe për mbarë rajonin. "Qëllimi është ta kërkoj mbështetjen nga partneri strategjik i Maqedonisë, SHBA-ja në prag të Samitit të NATO-s. Maqedonia e meriton vendin në NATO, punuam shumë. Treguam se Maqedonia është partner i përkushtuar ku anëtarët e Aleancës mund të konsiderojnë. Besojmë se ftesa për Maqedoninë për anëtarësim në NATO do të kontribuojë për stabilitetin tonë, por edhe për stabilitetin në rajon, dhe do të jetë në interes të SHBA-së", tha Shekerinska në konferencë për shtyp për mediat amerikane gjatë vizitës në Vermont. Ajo në konferencën për shtyp është përgjigjur në pyetjet e gazetarëve për takimet me guvernatorin dhe komandantin e Gardës Kombëtare në Vermont, për qëllimin e vizitës zyrtare në SHBA, për porosinë të cilat i ka marrë në takimet me personat zyrtarë në Uashington dhe rëndësinë e mbështetjes nga partneri strategjik për anëtarësim të Maqedonisë në NATO.

ISH-AMBASADORI FUERE PËR MIA-n

SHQETËSUESE NËSE SIVJET

NUK KA NEGOCIATA ME BE-në

"Nëse Greqia vazhdon të refuzojë edhe krahas të gjitha përpjekjeve të Qeverisë së Maqedonisë, të gjitha gjestet e vullnetit dhe besimit të mirë, nëse ende bllokojnë vendim pozitiv për negociata, mendoj se kjo do të tregojë se Greqia nuk e ka për zemër interesin e Ballkanit Perëndimor", thotë Fuere

Bruksel, 1 maj - Ish-ambasadori i Bashkimit Evropian në Maqedoni, Ervan Fuere, konsideron se nëse Këshilli i BE-së nuk miraton sivjet fillim të negociatave për vendin, atëherë i ardhshmi është i humbur për shkak të zgjedhjeve evropiane. Në intervistën për MIA-n ai i ka përsëritur "përpjekjet e mëdha" të Qeverisë, por tregoi edhe në dobësitë. Ish-ambasadori Fuere, i cili tani punon si ekspert në think thankun me ndikim kushtuar politikave evropiane (CEPS), para pak kohe publikoi mendim për raportet e fundit për Ballkanin Perëndimor dhe strategjinë e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ai ka shpresë të madhe se në qershor Këshilli i BE-së do të miratojë fillim të negociatave me Maqedoninë, madje edhe deri atëherë të mos jetë zgjidhur çështje e kontestit me emrin.

"Nëse Greqia vazhdon të refuzojë edhe krahas të gjitha përpjekjeve të Qeverisë së Maqedonisë, të gjitha gjestet e vullnetit dhe besimit të mirë, nëse ende bllokojnë vendim pozitiv për nego-



ciata, mendoj se kjo do të tregojë se Greqia nuk e ka për zemër interesin e Ballkanit Perëndimor", thotë Fuere. Ai shton se BE-ja ka kohë që deri në fund të vitit të japë dirë të gjelbër.

"Nëse nuk ka vendim pozitiv para përfundimit të vitit kjo atëherë do të thotë se nuk do të ketë negociata, sepse viti i ardhshëm do të jetë i humbur, sepse do të ripërtërihet Komisioni Evropian dhe do të ketë për Parlamentin Evropian. Shpresoj se do të realizohet porosia e Mogerinit në Maqedoni që Këshilli Evropian në qershor ta miratojë rekomandimin e KE-së. Në të kundërtën do të jetë negativisht, pozicioni i Qeverisë do të jetë i vështirë", saktëson Fuere. Ish-ambasadori evropian e përsëritet punën e Qeverisë në 11 muajt e fundit, por

paralajmëron dhe se duhet të fokusohet në reformat e brendshme dhe implementimin e tyre që është e fokusuar edhe në rregullimin e imazhit të saj të jashtëm.

"Mendoj se shumë kohë kaluan në imazhin e jashtëm, edhe pse është e kuptueshme, provojnë që këtë ta përmirësojnë, dhe kohë të pamjaftueshme i përkushtojnë miratimit të reformave ka dëshmi se po implementohet. Po, në të vërtetë ka përpjekje të sigurohen se nuk do të përsëritet çfarëdo qoftë nga sjelljet negative të pushtetit paraprak", thotë Fuere. Në intervistën për MIA-n, Fuere flet edhe për ligjin për përdorimin e gjuhëve, dhe paralajmëron se Qeveria duhet me vetiniciativë dhe sa është e mundur më shpejt ta dërgojë ligjin deri te Komisioni i Venecias, lajmëron kor-

respondentja e MIA-s nga Brukseli.

"Më vjen keq që nuk morën nisje ta dërgojnë ligjin deri te Komisioni i Venecias para se të votohet në Kuvend. Konsideroj se ka ishte gabim. Tani ligji është votuar, por nuk hynë në fuqi sepse që presidenti nuk e nënshkruan. Ndërkohë ligji duhet të shkojë deri te Komisioni i Venecias. Komisioni ka procedura urgjente të cilat mund të shfrytëzohen dhe çfarë rekomandimesh dhe të japë që ata të mundin të kyçen në ligjin dhe kjo do të ishte përgjigje e shkëlqyer deri te ata në opozitë të cilët pohojnë se ligji është antimaqedonas", thekson Fuere. Ish përfaqësuesi i Unionit paralajmëron edhe se Qeveria nuk dihet të bjerë në joshje të shkojë në zgjedhje të parakohshme.

ZAEVI URON, SINDIKALISTËT I DORËZUAN KËRKESAT PËR KUSHTE NË PUNË

Kujdesi për punëtorët, një prej prioriteteve të Qeverisë

Shkup, 1 maj - Lufta për të drejta më të mëdha të punëtorëve është angazhimi ynë i përbashkët, të bashkuar, të ndërtojmë shtet prosperues, civil, i barabartë për të gjithë, thotë kryeministri Zoran Zaev në urimin deri te të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Majit. Ai thekson se e drejta themelore e njeriut është të mbrohet dhe të jetë i sigurt në vendin e punës, ndërsa tipar i çdo shoqërie të civilizuar dhe bashkëkohore është respektimi dhe vlerësimi i punës së secilit në mënyrë të barabartë. "Jemi të vendosur dhe të përkushtuar në ndërtimin e një shoqërie të barabartë për të gjithë, ndërsa kujdesi për standardin e punëtorëve është një prej prioriteteve tona. Jemi të gatshëm fuqi-



shëm ta mbështesim zhvillimin e ndërmarrjeve vendore, sepse vetëm punëtorët e motivuar mund ta krijojnë ekonominë, të jenë nxitës i saj. Vetëm ashtu mund të sigurojmë jetë cilësore, vende pune dinjitoze, paga të denja dhe pensione, Maqedoni progresive dhe prosperuese", thekson kryeministri Zaev në urim. Në urimin me

rastin e 1 Majit, Zaev e theksoi gjithëpërfshirjen sociale dhe ekonomike për të cilën thotë se duhet të zhvillohet paralel me realizimin e prioriteteve të Qeverisë për rritje dhe zhvillim ekonomik, me krijimin e vendeve të reja të punës dhe me rritjen e konkurrencës në tregun e punës. "Urime Ditën Ndërkombëtare të Punës. Të vazh-

dojmë bashkërisht të ndërtojmë shtet social të cilën e parashikon Kushtetuta jonë, t'i bëjmë të gjitha hapat për zgjidhjen e aspekteve sociale të jetesës tonë. Para pothuajse një viti paralajmëruam dhe në muajt e fundit kjo ndodhi, kthimi i shtetit, Maqedonisë tonë në duart e punëtorëve dhe qytetarëve. Ta ndërtojmë së bashku Maqedoninë si vend i mundësive për të gjithë, shtet demokratik dhe prosperues, i denjë për jetesë", thekson kryeministri Zaev në urimin me 1 Majin. Ndërkohë, kryetari i Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë (LSM), Darko Dimovski dje i dorëzoi kërkesat e sindikalistëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Paraprakisht, para ndërtesës së Qeverisë të gjitha shoqatat sindikale erdhën të ba-

shkuara edhe pse marshet protestuese i filluan në lokacione të ndryshme. "Ky është fillimi i rikthimit të besimit në lëvizjen sindikalistë. Do të ballafaqohemi me të gjithë që do ta tradhetojnë lëvizjen punëtorë dhe Sindikatën", tha Dimovski para se ta dorëzoi dhe zyrtarisht Deklaratën me kërkesa në Qeveri. Ai porositi se vetëm tani është më shumë se e nevojshme se pse klasa punëtorë është e përçarë. Për momentin para Qeverisë mbërritën edhe pjesëmarrësit në protestën kundër përmbarsjes në organizim të Konfederatës së organizatave sindikaliste. "Protestojmë kundër përmbarsjesve. Kërkojmë ndalimin urgjent të të gjitha llogarive të bllokuara të qytetarëve dhe ligj të ri për përmbarsim", tha Ana Gligorova.

1 MAJ 2012, GJASHTË VJET NGA TERRORI POLICOR NË SHTËPITË E SHQIPTARËVE

"MONSTRA" TË MOS ZVARRITET



Shfuqizimin e aktakuzës për rastin "Monstra" dhe vërtetimin e faktit se shqiptarët e akuzuar në këtë lëndë nuk e kanë kryer vrasjen makabre në Liqenin e Smlikovës, e presin edhe familjarët e Hakiut, Samiut dhe Agimit. Paralajmërimet për reformimin e sistemit gjyqësor në vend ato i lidhin me procesin gjyqësor për "Monstrën", me çka shprehen se për disa seanca, kjo katrahurë kundër tyre dhe viktimave tjera duhet të ketë epilog

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 1 maj - Rigjykimi i rastit "Monstra" duhet të përfundojë brenda këtij viti, pasi akuzat për "terrorizëm" kundër gjashtë shqiptarëve të akuzuar janë të paqëndrueshme. Në përvjetorin e gjashtë të aksionit policor "Monstra", pala mbrojtëse e të akuzuarve është shprehur optimiste se rifilimi i këtij procesi gjyqësor do të përmbyllet për kohë të shkurtër. Mendimin se Haki e Fejzi Aziri, Agim dhe Afrim Ismailloviq, Halil Demiri e Sami Luta janë të pafajshëm, e kanë përsëritur edhe familjarët e tyre, të cilët këmbëngulin se prokuroria dhe gjykata duhet t'i liroi ato nga aktakuza për shkak se nuk kanë asnjë farë lidhje me vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës.

"Tash pasi PSP e mori përsipër lëndën dhe shqyrtimin e saj, ne si avokat presim tërheqjen e aktakuzës ndaj klientëve tanë. Provat e propozuara nga Prokuroria për krim të organizuar kanë qenë të montuar dhe të njëjtat, sipas nesh, nuk ekzistojnë fare. Ata nuk kanë pasur asnjë provë materiale apo verbale. Besoj se në seancat e radhës do të vërtetohet se dëshmitari i koduar në rastin Monstra ka qenë në realitet një dëshmitar i rrejshëm, në bazë të të cilët u zhvillua edhe i gjithë procesi i mëparshëm gjyqësor. Deklaratat kontradiktore të këtij dëshmitari në i kemi dëshmuar edhe në seancat e kaluara.

Tani, pasi që PSP është përfaqësuese e aktakuzës, mendoj se më mirë do ta sqarojmë këtë dilemë se i gjithë rasti është i montuar", tha për gazetën KOHA, avokati Naser Raufi.

Shfuqizimin e aktakuzës për rastin "Monstra" dhe vërtetimin e faktit se shqiptarët e akuzuar në këtë lëndë nuk e kanë kryer vrasjen makabre në Liqenin e Smlikovës, e presin edhe familjarët e Hakiut, Samiut dhe Agimit. Paralajmërimet për reformimin e sistemit gjyqësor në vend ato i lidhin me procesin gjyqësor për "Monstrën", me çka shprehen se për disa seanca, kjo katrahurë kundër tyre dhe viktimave tjera duhet të ketë epilog.

"Mendoj se me vetë ndërhyrjen e PSP-së, tregohet qartë se ekzistojnë përgjime për këtë rast dhe të njëjtat lidhen me lëndën. Ne meqë jemi të bindur në pafajësinë e bijve tanë, presim nga PSP në afat sa më të shkurtër ta korrigjojë këtë padrejtësi dhe familjarët tanë të lirohen nga aktakuza.

Përgjatë gjashtë viteve të kaluara, ne 1 majin e kujtojmë si një datë të terrorit dhe torturës fizike e psikike që atë kohë u ushtrua ndaj neve dhe të afërmeve tanë. Kur të raportohet për këtë datë, mendoj se ngjarja e 1 maji e vitit 2012, duhet të nënvizohet me logon '+18', me të vetmin qëllim që personat nën këtë moshë mos të lexojnë për brutalitetin e ushtruar ndaj nesh atë ditë", tha Be-

dri Ajdari. Ndryshe, për herë të parë pas gjashtë vitesh, pjesa dërmuese e të akuzuarve në rastin "Monstra", përvjetorin e hidhur të padrejtësisë ndaj tyre e kanë pritur në shtëpi. Përkujtimi i kësaj datë jashtë grilave të burgut, siç thonë familjarët e të akuzuarve rastin "Monstra", ka qenë përplot emocionale. Vuajtja e burgut për Haki Azirin dhe të akuzuarit tjerë, siç njoftojnë të afërmit e tyre, ka qenë tepër e rëndë, duke pasur parasysh kushtet e burgjeve dhe më së tepërmi për akuzën e "terrorizmit", vepër kjo e cila aspak nuk ka të bëjë me ato. Megjithatë, ata theksojnë se liria është liri dhe ajo nuk ka fjalë më të cilat mund të përshkruhet.

Ndërkohë, krahas Halil Demirit dhe Afrim Ismailloviqit, të cilët nuk gjenden në Maqedoni, në burg edhe tutje, mirëpo për vepër tjetër penale - vazhdon të qëndroj Fejzi Aziri. Seanca e fundit për rastin "Monstra" u anulua për datë 16 maj për të vetmen arsye se Fejzi Aziri ishte në gjendje të rëndë shëndetësore dhe nuk mori pjesë këtë seancë. Për këtë arsye, nga Qendra Klinike në Shkup, ai javë më parë u transferuar në burgun e Shtipit, i cili në të ardhmen mban përgjegjësinë për transferimin e Fejzi Azirit në Gjykatën Penale të Shkupit. Të afërmit e tij thonë se gjendja shëndetësore e Azirit i ndryshon herë pas herë dhe tash mbetet ta vlerësoj drejtorja e burgut të Shtipit se a do të marrë pjesë në seancën e 16 majit ose jo.

KRONIKË

Shkupjani kapet me pistoletë në Gostivar

Gjatë kontrollit në rrugën e "Ilindenit" në Gostivar, efektivët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, stacioni policor në Gostivar, kanë ndaluar veturën "Golf" me targa të Shkupit, e drejtuar nga personi A.L. 32 vjeçar nga Shkupi. Gjatë kontrollit, në veturë është gjetur një çantë dore e zezë, në të cilën ka pasur një pistoletë të tipit "TT" e kalibrit 7,62 milimetër, me karikues të mbushur me 9 plumba, të cilën A.L. e ka poseduar pa leje. Gjatë kontrollit i njëjti ka tentuar të arratiset, por menjëherë është kapur nga efektivët e policisë. Personi A.L. është privuar nga liria, dhe është mbajtur në Stacionin policor të Gostivarit, për procedurë të mëtejshme.

Pallçisht, largohet nga shtëpia 15 vjeçarja

Është denoncuar se në fshatin Pallçisht i Epërm është larguar nga shtëpia një 15-vjeçare dhe nuk është kthyer. Largimin e saj e ka denoncuar vëllai i saj, sipas të cilit, motra e tij nuk ka patur asnjë dokument me vete dhe ka qenë pa telefon celular. Policia ka marrë masa për zbardhjen e rastit.

Tre të lënduar në aksidentin e Reçicës

Në rrugën rajonale Tetovë-Pirok, në Reçicë të Madhe, ka ndodhur aksident në komunikacion, ku pjesëmarrës kanë qenë dy vetura me targa të Tetovës edhe atë "Pezho 306", të cilën pa leje për vozitje e ka drejtuar personi me iniciale Sh.F. 36-vjeçar nga fshati Novosellë, dhe "Wolfsagen Lupo", drejtuar nga personi E.B. 21-vjeçar nga Tetova, gjithashtu pa leje për vozitje. Në këtë aksident, bashkudhëtarja e veturës në "Pezho 306" me iniciale R.F. 76-vjeçare ka marrë lëndime të rënda trupore, gjithashtu lëndime trupore kanë marrë edhe dy bashkudhëtarë tjerë. Tre personat e lënduar janë dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës, për dhënien e ndihmës mjekësore.

Plaçkitet një pompë benzine në Shkup

Dy persona të panjohur duke u kërcënuar me armë, mbrëmë kanë plaçkitur një pompë benzine në rrugën "Aleksandar Urdarevski" në Shkup. Policia kumtoi se rreth orës 2:20 në SPB Shkup është paraqitur se në rrugën "Aleksandar Urdarevski", në pompën e benzinës dy persona të panjohur me kërcënim me armë kanë kryer plaçkitje, me ç'rast janë marrë para nga qarkullimi ditor. Merren masa për zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Gruevski tre ditë me radhë në gjykatë

Shkup, 1 maj - Seanca për katër lëndë të Prokurorisë Speciale Publike, "Treqind", "Titanik", "Dhunë në Qendër" dhe "TNT" janë caktuar për këtë javë në Gjykatën Penale. Për sot (e mërkurë) është caktuar seanca për "Titanik", që është rasti i parë i zbardhur nga PSP. Krahas ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, në këtë rast janë të akuzuar edhe ish-funksionarët Martin Protugjer, Kirill

Bozhinovski, Mile Janakievski, Gordana Janullovska, Biljana Brshkoska Boshkovski, si dhe Ilija Dimovski, Munir Pepiq, Edmond Temellko, Lek Ristovski, Kiril Todorovski, Katerina Vellovska, Stanko Korunovski, Kosta Markovski, Dragçe Dragçeski, Marjan Nekevski, Coce Janevski, Xhezmi Ahmet, Robert Davitkov, Dalibor Aleshkoviq dhe Lenka Rashajkovska. Ata janë të dy-

shuar nga PSP-ja për shoqërim kriminal, shkelje të të drejtës zgjedhore, shkelje të lirisë së përcaktimit të votuesve, ryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit, shkatërrim të materialit zgjedhor dhe keqpërdorim të mjeteve për financim të fushatës zgjedhore në vitin 2012. Të enjten në bankën e të akuzuarve do të ulen të akuzuarit në rastin "Treqind" dhe "Dhunë në Qendër". Në

lëndën "Treqind" është i akuzuar Gjoko Popovski ish ndihmësmnistër në MPB për furnizimin e 300 automjeteve për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në bankën e të akuzuarve të premtën do të ulen edhe të akuzuarit në lëndën "TNT", që ka të bëjë për rrëzimin e kompleksit "Kosmos" të biznesmenit dhe kryetar i Partisë për Ardhmëri Evropiane (PAE), Fijat Canovski.

LARG STANDARDEVE EVROPIANE EDHE SIPAS NUMRAVE

SHUMË UNIVERSITETE, PAK CILËSI

Me 23 institucione të arsimit të lartë, në një shtet me 2 milionë banorë dhe jo më shumë se 36 mijë metra katrorë, na kanë larguar shumë nga standardet evropiane si për nga cilësia, ashtu edhe të krahasuar numerikisht. Sipas kriterëve që përdoren në Evropë, ka një universitet publik për 600.000-700.000 banorë. Pra, i bie që në Maqedoni të ishin realisht tre universitete publike, por assesi gjashtë

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 1 maj - Në një shtet ku për dy milionë banorë dhe me jo më shumë se 17 mijë maturanë funksionojnë 23 institucione të arsimit të lartë, është e kotë të shpresosh në vlerën e diplomës universitare si një arritje e lartë, deri te e cila nuk mund të mbërrijë çdo kush. Humbja e kontrollit mbi tregun e institucioneve të arsimit të lartë, për shkak të hapjes pa kriterë të universiteteve dhe institucioneve tjera të arsimit të lartë, e ka kthyer



Maqedoninë në vendin ku diplomat e universiteteve shërbejnë më tepër si mjet përfitimi e interesi politik se sa mekanizëm për avancimin e shkencës dhe zhvillimin e shoqërisë. Në listën e institucioneve të akredituara të arsimit të lartë në Maqedoni gjenden gjashtë universitete publike, 12 institucione private, tre shkolla të larta dhe dy fakultete me karakter fetar.

Kështu, 23 institucione të arsimit të lartë, në një shtet që nuk ka më tepër se 36 mijë metra katrorë dhe 2 milionë banorë, sipas ekspertëve të fushës, na kanë larguar shumë nga standardet evropiane edhe atë jo vetëm për nga cilësia, por edhe të krahasuar numerikisht.

"Numri i madh i universiteteve në një shtet të vogël si Maqedonia, nuk është diçka për tu vlerësuar. Përkundrazi, është tregues i mungesës së cilësisë, rënies së kriterëve, pra që në këtë sferë gjërat

nuk shkojnë sikurse duhet", vëren prof.dr.Avzi Mustafa, ndërsa nuk nguron të drejton gishtin nga politika. S'ka dyshim, plotëson më tej ai, se për nivelin e ulët në të cilën kanë rënë universitetet tona dhe për degradimin e diplomave në përgjithësi, fajtojnë kryesore është politika. Sepse, universitetet qofshin publike apo private, në rastet më të shpeshta janë hapur jo sepse kjo ka qenë nevojë për zhvillimin e arsimit në nivelin e lartë, por sepse pas atyre iniciativave qëndron politika.

"Kjo është rruga nëpër të cilën fatkeqësisht kalon themelimi i universiteteve dhe fakulteteve në Maqedoni për disa dekada me radhë. Prandaj, kemi dyfish më tepër universitete se sa është ky raport në shtetet e zhvilluara evropiane", shton Mustafa. Sipas kriterëve që përdoren në Evropë, ka një universitet publik për 600.000-700.000 banorë. Pra, i bie që në Maqedoni

të ishin realisht tre universitete publike, por assesi gjashtë. Universitetet private do të duhej të ishin të lidhura ngushtë me nevojat e tregut, konkretisht korporatat dhe kompanitë e fuqishme me qëllim të prodhimit të kuadrove për nevojat e këtyre të fundit. Mirëpo, siç është bërë traditë të vërtetohemi deri tani, kjo hallkë mes universiteteve dhe nevojave të tregut tek ne mund të ketë ekzistuar vetëm rastësisht.

"Problem jonë është se hapja e një numri kaq të madh të institucioneve të arsimit të lartë i ka konvencuar politikës, konkretisht nevojave të atyre që, kur janë në pushtet - duhet të mbështeten në platforma populiste, duhet të zgjidhur problemet me punësimin e njerëzve që duhet t'i shpërblejnë dhe për arsye të ngjashme", shpjegon Mustafa

Me hapjen e kaq shumë universiteteve, është ulur në mënyrë



AVZI MUSTAFA

Numri i madh i universiteteve në një shtet të vogël si Maqedonia, nuk është diçka për tu vlerësuar. Përkundrazi, është tregues i mungesës së cilësisë, rënies së kriterëve, pra që në këtë sferë gjërat nuk shkojnë sikurse duhet. S'ka dyshim se për nivelin e ulët në të cilën kanë rënë universitetet tona dhe për degradimin e diplomave në përgjithësi, fajtojnë kryesore është politika

fiktive numri i papunësisë. Sepse, duke i kthyer universitetet si diçka ku duhet të regjistrohen të gjithë, ulët në mënyrë artificiale numri i të papunëve. Rreth 17 mijë persona në vit që kryejnë arsimin e mesëm, në vend që të shkojnë në tregun e punës, regjistrohen në fakultet, pra nuk figurojnë si të papunë për 4-5 vitet e ardhshme. Mirëpo, e gjithë kjo ka shkuar në dëm të cilësisë të arsimit të lartë. Nuk është rastësi që universitetet nga Maqedonia gjenden në pozita tejet të disfavorsme të ranglistave që matin performancat e universiteteve në nivel të Evropës dhe botës.

VAZHDON LARGIMI I TË RINJVE NGA MAQEDONIA

E ardhmja jashtë vendit!

Ylber Gashi, kryetar i Unionit të Shkollave të Mesme me mësim në gjuhën shqipe, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë dy arsye kryesore që i bëjnë të rinjtë të largohen nga vendi, gjendja e rëndë ekonomike dhe rënia e cilësisë së arsimit

Shkup, 1 maj - Shkalla e lartë e papunësisë ka bërë që të rinjtë në Maqedoni të ardhmen e tyre gjithnjë e më shumë ta shohin jashtë vendit. Përderisa institucionet shtetërore nuk kanë informa-

cion për numrin e të rinjve që janë larguar nga vendi, madje nuk dihen as profilet e atyre, të cilët janë larguar për gjetur punë në ndonjë nga vendet e Bashkimit Evropian, në bazë të të dhënave të Bankës Botërore, shkalla e papunësisë në mesin e të rinjve në Maqedoni, është mbi 50 për qind. Ylber Gashi, kryetar i Unionit të Shkollave të Mesme me mësim në gjuhën shqipe, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë dy arsye kryesore që i bëjnë të rinjtë të largohen nga vendi, gjendja e rëndë ekonomike dhe rënia e cilësisë së arsimit. "Përpos asaj se janë shkaqet ekonomike, rinia nga Maqedonia largohet edhe për arsye se puna e tyre, qoftë ajo fizike apo intelektuale, nuk paguhet mirë, përkatësisht nuk vlerësohet aq sa duhet. Sa i përket procesit të arsimit, mungojnë kushtet sa i përket cilësisë, dhe nga ana tjetër edhe

pse dikush përfundon studimet me sukses të lartë, për shkak të nepotizmit dhe influencës politike, nuk arrin të punësohet. Kjo i dekurajon të rinjtë për ta parë perspektivën në vend", thotë Gashi. Ndryshe, në bazë të një hulumtimi të realizuar nga Koalicioni i të rinjve "Sega", një e katërta e të rinjve në Maqedoni, të cilët nuk janë të përfshirë fare në sistemin e punës, nuk ndjekin arsimin e lartë apo trajnime për t'u kualifikuar në ndonjë lëmi.

"Pikërisht ky grup duhet të jetë në fokus të politikave të autoriteteve udhëheqëse të vendit për punësim, sepse kështu është në vendet e zhvilluara demokratike. Kjo ngaqë pasivizimi i këtij kapitali njerëzor, paraqet kërcënim apo rrezik, jo vetëm për të ardhmen e kësaj kategorie, por për mbarë shoqërinë, sepse bëhet fjalë për një shifër të lartë të të

rinjve përkatësisht rreth 25 për qind e tyre. Pra, duhet bërë çmos që këta të rinj të kthehen në tregun e punës përmes aftësimin të tyre në lëmi të caktuara", thotë për Radion Evropa e Lirë, Zoran Iliovski, nga organizata që në fokus ka të drejtat e të rinjve "Sega". Ndërkaq, Samet Shabani gjatë një projekti hulumtues "Migrimi i të rinjve", ka ardhur në përfundim se gjatë dhjetë viteve të fundit janë të rinjtë me arsimim të lartë ata që largohen më së shumti nga Maqedonia. "Sidomos në dekadëshin e fundit, ka një rritje ekstreme në migrimin e të rinjve me arsim të lartë të përfunduar, gjegjësisht migrimi i njohur si 'migrimi i trurit', domethënë kategoria e të rinjve që kërkojnë punë jo fizike. Mendoj se pikërisht ky lloj i migrimit shkakton gjendje alarmante për ardhmërinë e shtetit dhe në këtë pikë shteti duhet të

marrë përmasa serioze për parandalimin e këtij fenomeni". "Në këtë kontekst, besoj se implementimi i meritokracisë, gjegjësisht punësimin në bazë të meritës e jo lojalitetit partiak është një ndër hapat më të rëndësishme që rini-së t'i kthehet shpresa për perspektivë në vend", vlerëson Shabani. Organizatat që në fokus kanë të rinjtë, thonë se Maqedonia do të paguajë kosto të lartë për shkak të largimit të të rinjve nga vendi dhe ngritjes së mesatares së moshës. Ata theksojnë se ka një disbalancë mes asaj se çka ofrojnë universitetet dhe çka në të vërtetë kërkon tregu i punës. Sipas tyre, një nga sfidat më të mëdha të Maqedonisë si shtet, do të jetë harmonizimi i kërkesave mes sektorit të biznesit dhe fakulteteve në funksion të ngritjes së një perspektive të qëndrueshme për të rinjtë. (REL)

Në Tetovën e dy universiteteve, në Tetovën e selive të partive politike... në mënyrë legale me amimin e shtetit funksionojnë mbi 50 kazino dhe dyfish më shumë bastore, të vendosura vend e pa vend, afër shkollave, institucioneve shtetërore, në zemër të qytetit duke zaptuar lokalet më atraktive dhe duke tërhequr edhe fëmijë të mitur

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 1 maj - Komuna e Tetovës më në fund ka kërkuar që të kyçet në debatin për Ligjin e ri për lojërat e fatit. Në seancën e fundit të Këshillit të Komunës së Tetovës, është sjellë vendim që Komuna e Tetovës të jetë pjesë e debatit dhe të jep propozimet e saj që këto objekte të lojërave të fatit të jenë sa më larg objekteve shkollore dhe atyre publike. Këtë e ka konfirmuar edhe vetë kryetari i Këshillit të Komunës së Tetovës së Tetovës, Bekim Memeti.

"Në Seancën e fundit të Këshillit që është mbajtur, Këshilli dhe Komuna e Tetovës është kyçur në debatin publik të hapur nga Ministria e Financës dhe nga Qeveria me çrast edhe ne si Këshill sugjeruam dhe vendosëm për pikat me të cilat ne si institucion planifikojmë të kyçemi në këtë debat të hapur", tha Memeti, duke shtuar se më tej do të jepen propozime konkrete në këtë drejtim. "Domethënë, përveç pikave të cilat tanimë veçse janë të parapara nga institucionet, ne vendosëm që atyre pikave t'ju shtojmë

KOMUNA E TETOVËS KYÇET NË DEBATIN PËR LOJËRAT E FATIT

MBI 50 KAZINO DHE DYFISH MË SHUMË BASTORE



SHPRESA ISEINI

Sa i përket hapjes së kazinove dhe bastoreve, duhet që prindërit kudo që janë, qoftë nëpërmjet institucioneve edukativo-arsimore, këshillit të prindërve... të ndërmarrin masa dhe të bëjnë kërkesë që mos të hapen më dhe këto që janë - shumica edhe të mbyllen sepse nuk kemi nevojë që në këtë mënyrë të edukohen fëmijët tanë

edhe disa pika të tjera për të cilat mendojmë se ia vlen të jenë si pjesë e Ligjit përkatës, i cili në të ardhmen pritet të sillt, domethënë planifikohet që distanca të rritet nga 100 metra sa është tani në 300 metra dhe aty të përfshihen më shumë institucione shtetërore si çerdhe, komuna, spitale, objekte fetare e kështu me radhë", deklaroi kryetari i Këshillit të Komunës së Tetovës.

Nga shkollat fillore në Tetovë thonë se hapja e objekteve të lojërave të fatit në afërsi të këtyre institu-

cioneve është një dukuri negative që ndikon negativisht në shoqëri dhe pikërisht në gjeneratat e reja, pasi me të madhe janë hapur kazino dhe bastoret sportive të cilat e gënjejnë rininë.

"Sa i përket procesit edukativo-arsimor, pasi përfshin jo vetëm arsimit, por edhe edukimin, ne kemi paraparë që edhe gjatë orëve të klases të ditës së hënë ti ndahet një orë, vazhdimisht secilën javë nga një orë të ndahet dhe të flitet për këtë çështje, edhe pse në këtë drej-

tim më së shumti duhet që shtetit të merret me këtë dukuri, dhe të bëjë parandalimin e hapjeve të mëtejshme sepse është një proces shumë i zgjeruar jo vetëm në qytetin tonë, por edhe në qytetet e tjera të vendit tonë. Kështu që ndikim të madh mund të them se ka edhe familja, sepse edukimi fillon prapë që në familje dhe më pas në shkollë dhe shoqëri", deklaroi Shpresa Iseini, drejtoreshë e shkollës fillore "Liria" në Tetovë. Ajo madje kërkon që bastoret dhe kazinot të mbyllen.

"Ne vazhdimisht mundohemi që fëmijët ti edukojmë në frymën që duhet të mësojnë dhe të punojnë në mënyrë të nderme dhe të arrihet qëllimi dhe ideali i çdo nxënësi që e ka atë primare. Sa i përket hapjes së kazinove dhe bastoreve, duhet që prindërit kudo që janë, qoftë nëpërmjet institucione-



BEKIM MEMETI

Në Seancën e fundit të Këshillit që është mbajtur, Këshilli dhe Komuna e Tetovës është kyçur në debatin publik të hapur nga Ministria e Financës dhe nga Qeveria me çrast edhe ne si Këshill sugjeruam dhe vendosëm për pikat me të cilat ne si institucion planifikojmë të kyçemi në këtë debat të hapur

ve edukativo-arsimore, këshillit të prindërve... të ndërmarrin masa dhe të bëjnë kërkesë që mos të hapen më dhe këto që janë - shumica edhe të mbyllen sepse nuk kemi nevojë që në këtë mënyrë të edukohen fëmijët tanë", thotë drejtoresha Iseini. Ndryshe, në Tetovën e dy universiteteve, në Tetovën e selive të partive politike... në mënyrë legale me amimin e shtetit funksionojnë mbi 50 kazino dhe dyfish më shumë bastore, të vendosura vend e pa vend, afër shkollave, institucioneve shtetërore, në zemër të qytetit duke zaptuar lokalet më atraktive duke tërhequr edhe fëmijë të mitur.

Kushte dinjitoze për punën e gazetarëve

Shkup, 1 maj - Kërkojmë kushte dinjitoze për punë dhe pagë dinjitoze, porositi sot kryetarja e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Medial (SPGM), Tamara Çaushidis para fillimit të protestës së 1 Majit. "Viteve të kaluara një pjesë e sindikatave nuk u pajtuan të heshtin. Ishin në rrugë, sot përsëri janë në rrugë. Kemi marrë mjaft premtime, por situata nuk është duke u përmirësuar", theksoi Çaushidis. Protestës që e organizon SPGM i bashkuan edhe Sindikata e Kulturës së Republikës së Maqedonisë, Sindikata e shërbimit diplomatik si edhe Sindikata e pavarur akademike. Nga Sindikata e kulturës porositën se në institucione kulturore po ndodh kaos administrativ, ndërsa Sindikata e Pavarur Akademike kërkoi të ndalojë praktika e financimit të ulët të arsimit të lartë dhe veprimtarisë shkencorohulumtuese. Marshi protestues i SPGM-së filloi nga sheshi "Kryengritja e Karposhit" dhe përmes Urës së Gurit vazhdoi drejt Kuvendit të Republikës së Maqedonisë e më pas drejt Qeverisë.

Gjobiten 71 motoçikleta me nga 500 euro

Tetovë, 1 maj - Në fillim të vikendit që kaloi, në Tetovë dhe Gostivar, është kthyer një kontroll aksion lokal disa orësh, të motoçiklistëve pjesëmarrës në komunikacion. Gjatë kontrollit dhe aktiviteteve në Tetovë, janë zbuluar 71 kundërvajtje, ku shumica janë për mospërdorim të helmetës mbrojtëse, drejtim pa leje, dhe me regjistrim të skaduar, derisa numri i përgjithshëm i kundërvajtjeve të zbuluara në Gostivar është gjithsej 58. Të gjitha kundërvajtjet janë kompletuar edhe me fletëpagesa të detyrueshme ose për kundërvajtje, të cilat krahas llojit të kundërvajtjes shumat e dënimeve lëvizin prej 50-500 euro, në kundërvlerë të denarit. Krahas kësaj, për shkak të kundërvajtjes doganore, nga ana e policisë janë marrë edhe dy motoçikleta, edhe atë një në Tetovë dhe një në Gostivar.

Numri më i madh i kundërvajtësve, gjithashtu do jenë të thirrur për edukim në komunikacion, ku para së gjithash personat që kanë drejtuar pa leje për vozitje, dhe pa pajisjet mbrojtëse për motoçikletë ku më së shumti është e nevoj-



shme helmeta mbrojtëse. Aktivitete të këtilla kontrolluese dhe preventive, do të pasojnë edhe muajve të ardhshëm, ku si theks të veçantë do të kenë, kundërvajtjet më të shpeshta gjatë këtij viti edhe atë, drejtim pa leje për vozitje, dhe pa helmetë mbrojtëse. Kjo për shkak se gjatë këtij muaji, në rajonin më të gjerë të Pollogut, kanë ndodhur disa aksidente trafiku, me pasojë serio-

ze, ku pjesëmarrës kanë qenë motoçiklistët. SPB Tetovë, edhe një herë apelon deri te kjo kategori e pjesëmarrësve në komunikacion, numri i të cilëve ditëve në vijim do të jetë edhe më i madh, të shfrytëzojnë detyrimisht helmetë mbrojtëse dhe pajisje tjera për mbrojtje, më së shumti për siguri personale, dhe të mos ulen mbrapa drejtuesit pa leje për vozitje.

Këshilli i Tetovës jep leje për çerdhe të re

Tetovë, 1 maj - Këshilli i Komunës së Tetovës ka vendosur për iniciimin dhe për plotësimin e dokumentacionit për një çerdhe të re në Tetovë. Çerdhet e Tetovës janë të mbi populluara dhe nga viti në vit ka më shumë fëmijë se sa ka kanë kapacitetet për të pranuar. Kjo situatë tashmë është e pranishme vite me radhë, ngase rritet numri i prindërve që dërgojnë fëmijët në çerdhe. "Gjithashtu, në mbledhje të fundit të Këshillit komunal është vendosur për iniciimin dhe për plotësimin e dokumentacionit për një çerdhe të re, e cila do të duhet të kalojë edhe në Qeveri si e tillë, por si pasojë e kohës apo tajmingut të shkurtër deri më 2 maj, kur edhe do të duhet të dorëzohet - vendosëm që ajo patjetër të kalonte edhe në Këshillin komunal, që domethënë se iniciativa ka filluar tani mbetet që e njëjta të kalojë edhe në Qeveri dhe më pas të realizohet edhe hapat tjerë për krijimin e çerdes", deklaroi Bekim Memeti, kryetar i Këshillit të Komunës së Tetovës. Sipas informacioneve, çerdhja tek shkolla ekonomike ka kapacitet për 120 fëmijë ndërsa janë regjistruar 170. Në çerdhen Teteks kapaciteti është për 160 fëmijë, kurse janë pranuar 220. Çerdhja e Vjetër gjithsej ka kapacitet për 90 fëmijë, kurse janë regjistruar 130. Në objektin në lagjen Potok kapaciteti është për 120 fëmijë, kurse 165 janë të regjistruar. (U.H)

Këtë vit do të ndërtohen 29 rrugë rajonale

Prilep, 1 maj - Për momentin, në vend po punohet në 10 rrugë rajonale, ndërsa deri në fund të vitit do të rikonstruktohen 29 rrugë rajonale në Maqedoni, deklaroi ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski. Ai, së bashku me kryebashkiakun e Prilepit, Ilija Jovanoski, i mbikëqyri punimet në asfaltimin e rrugës nga Prilepi deri në Liqenin artificial, një nga më të frekuentuarit dhe më të pasigurtit në rethinën e Prilepit. "Bëhet fjalë për aks rrugor prej tetë kilometrash nga Prilepi deri në Liqenin artificial. Janë ndarë 20 milionë denarë, gjysma nga NP për rrugë shtetërore dhe nga vetëqeverisja lokale e Prilepit. Rekonstruktimi i këtij aksi rrugor është kërkesë e banorëve të komunës së Prilepit. Bëhet fjalë për rrugë tërësisht të pasigurta. Këto para janë për 2.6 kilometra. Përndryshe, NP për rrugë shtetërore për momentin po punon në 10 rrugë rajonale të shtetit. Është planifikuar që sipas Programit të ndërmarrjes me 467 milionë denarë gjatë këtij viti të rikonstruktohen 29 akse rrugore rajonale në shtet", tha Sugareski. Ministri i Transportit dhe Lidhjeve Goran Sugareski apelon deri te komunat që t'i shfrytëzojnë paratë për infrastrukturë dhe nga Banka Evropiane e Investimeve dhe për ujësjellës dhe kanalizim.

MJEKËT PO RRALLOHEN E RADHËT NË KLINIKA SHTOHEN

I SËMURË NË BALLKAN, PARATË NË DORË OSE PRIT!



Mjekët po rrallohen e radhët në klinika shtohen. Kujt është i sëmurë në Ballkan i duhet durim. Ose të ketë shumë para. Por paralelisht me sistemin shtetëror është krijuar një botë paralele klinikash private

Shkup, 1 maj - "Këtë mund ta zgjidhim privatisht". Kjo fjali magjike dëgjohej rregullisht në Ballkan, edhe Natasha e dëgjoi, kur donte të mbyllte një orar për kontroll në spital. 30 vjeçarja nga Novi Sadi sapo ka lënë pas vuajtjet e një tumori në sistemin limfatik dhe nuk do të humbasë kohë. Por ajo nuk ka para për të paguar "privatisht", jashtë sistemit të siguracionit shëndetësor shtetëror vizitën mjekësore.

Shumica e pacientëve në vendet e Ballkanit që përbënin dikur Jugosllavinë socialiste janë të varur nga sistemi shëndetësor shtetëror. Për qytetarët në Serbi, Maqedoni apo Bosnje, ku rroga mesatare është rreth 400 euro neto dhe papunësia kalon 20%, kontrollet private tek mjeku janë një luks i paarrtshëm. Këtë hap pacientët e ndërmarin vetëm në rast nevojë, kur pritja e gjatë kthehet në rrezik për shëndetin. Ose kush ka para.

NUK KA SHIRINGA DHE GJILPËRA

"Vajza ime u sëmur nga diabeti, kur ishte 16 muajshe. Kemi pritur më shumë se 6 vjet për një pompë insuline", kujton Mirela Shishiç, që drejton një shoqatë pacientësh në kryeqytetin boshnjak, Sarajevë. Për Deutsche Wellen ajo thotë, se spitalet nuk kanë as medikamentet bazë, megjithëse ato duhet të mbulohen nga siguracioni shëndetësor. Ilaçet që nuk i ofrojnë spitalet qytetarët i blejnë pastaj me çmim të plotë në farmaci.

Siguracioni shëndetësor shtetëror ofron shumë pak mjete financiare, shprehet një ish-drejtor që nuk do të përmendet me emër, dhe që për vite me radhë ka drejtuar disa spitale në Serbi. "Kështu në pjesën e dytë të vitit mungojnë

gjilpërat, shiringat, dhe dezinfektuesit. Pa harruar pjesët për aparatet e radiografisë." Ndërkohë ai punon tani për një spital privat, që nuk i ka këto probleme.

"Këtë mund ta zgjidhim privatisht". Kjo fjali magjike dëgjohej rregullisht në Ballkan, edhe Natasha e dëgjoi, kur donte të mbyllte një orar për kontroll në spital. 30 vjeçarja nga Novi Sadi sapo ka lënë pas vuajtjet e një tumori në sistemin limfatik dhe nuk do të humbasë kohë. Por ajo nuk ka para për të paguar "privatisht", jashtë sistemit të siguracionit shëndetësor shtetëror vizitën mjekësore.

Shumica e pacientëve në vendet e Ballkanit që përbënin dikur Jugosllavinë socialiste janë të varur nga sistemi shëndetësor shtetëror. Për qytetarët në Serbi, Maqedoni apo Bosnje, ku rroga mesatare është rreth 400 euro neto dhe papunësia kalon 20%, kontrollet private tek mjeku janë një luks i paarrtshëm. Këtë hap pacientët e ndërmarin vetëm në rast nevojë, kur pritja e gjatë kthehet në rrezik për shëndetin. Ose kush ka para.

NUK KA SHIRINGA DHE GJILPËRA

"Vajza ime u sëmur nga diabeti, kur ishte 16 muajshe. Kemi pritur më shumë se 6 vjet për një pompë insuline", kujton Mirela Shishiç, që drejton një shoqatë pacientësh në kryeqytetin boshnjak, Sarajevë. Për Deutsche Wellen ajo thotë, se spitalet nuk kanë as medikamentet bazë, megjithëse ato duhet të mbulohen nga siguracioni shëndetësor. Ilaçet që nuk i ofrojnë spitalet qytetarët i blejnë pastaj me çmim të plotë në farmaci. Siguracioni shëndetësor shtetëror ofron shumë pak mjete financiare, shprehet një ish-drejtor që nuk do të përmendet me

emër, dhe që për vite me radhë ka drejtuar disa spitale në Serbi. "Kështu në pjesën e dytë të vitit mungojnë gjilpërat, shiringat, dhe dezinfektuesit. Pa harruar pjesët për aparatet e radiografisë." Ndërkohë ai punon tani për një spital privat, që nuk i ka këto probleme.

MJEKËT LARGOHEM NGA VENDI

Në të njëjtën kohë nga vendet e Ballkanit po largohen shumë mjekë. "Vitin e kaluar 180 nga 220 mjekë të diplomuar kanë kërkuar një certifikatë që u mundëson punën jashtë vendit", thotë Goran Begoviç, kreu i sindikatës së mjekëve në klinikën qendrore të Shkupit. "Kjo shifër është e frikshme", thotë ai.

Destinacioni më i preferuar është Gjermania, ku një mjekë fiton 5 deri në 6 herë më shumë se në Serbi apo Maqedoni. Në vitin 2016, mjekët serbë përbënin grupin e tretë më të madh të mjekëve të lejuar për të punuar në Gjermani, pas sirianëve dhe rumunëve. Organizata Healthgrouper ka konstatuar se më shumë se treçetë e mjekëve në Serbi mendon për t'u larguar nga vendi. Situata është e ngjashme në vendet e tjera të Ballkanit.

Kështu krijohet një rreth vicioz, personeli mjekësor largohet nga vendi ose kalon në sektorin privat, ku pagat janë më të mira. Përballë këtyre qëndron një sistem shtetëror me shumë më pak para dhe mjekë e me lista të gjata pritjeje. Kollapsi i një sistemi të tillë duket si i paraprogramuar. Mirela Shishiç, që duhet të përballet me diabetin e fëmijës së saj në sistemin shëndetësor boshnjak nuk ka shumë shpresa: "Më parë do t'i shkatërroshin veshkat vajzës sime se sa do të kryhej ndonjë reformë". (DW)

La kryt pas femnave!

Nga

Adelina MARKU



"Ç'të ka kap zori pa ty gjene të shkruash për çdo gjë?" - m'a shpull dikush që heshtjen e ka bo diskurs jetel! "Pse mi, ma e mençmja na qenke ti që duhesh me fol!?" - do ma dalldis dikush; "Ti ki me u gjeg në xhenem moj kudër!" - do më shkruan një i/e tretë në FB, që them - ka aftësinë profetike se kush n'xhenem e kush n'xhenet. Hhmmm, fundja një gërmë i ndan këto dy destinacione postmortale a!; ose një i katërt: "Ti mujsh me shkru çdo gja veç mos shkruj për fenë tonë!" - do ma shpull një tjetër që shpall fenë time ndrysh' nga tijit e fafap e bon diktat mendjeje e m'përrjashton me hidhnm nacist, me rracizëm...; "Kqyre lopa, lopa që shkrun. Lop oj lop ...Hajt lop fluturo!" - do shkrun ndojnjani që ka lopën opesion, thu ti kur i vogël, ka pi qumësht direkt nga cica e lopës e aty, aty iu ka ngulu mendja përjetë!; "Ku po din mori ti me bo dallimin mes harramit e hallallit, ti je kaure!" - do ma xhigavnoj tjetër tuj mendu se ma mir se unë e njuh Zotin tim brenda mejel!; "Kjo don me u (ashtu...!)" - këtë m'a shkrun dikush që n'vend të trunit ka organ gjenital. Ah Frojd, o Frojd!; "Mos t'a mer mendja se ji ma e mençme se un, oj trullavic, oj budallicooooo!"; - kjo del nga ndoj tip narcisi t'vetmum, që masnej i bjen pishmanit se m'quan budallic se kish mund të më thotë psh "oj/ma/pak/e/ mençmja/se/un psh!" Se këta tipa vdesin dikush ti dojë! Jam ma i miri, ma i bukri, ma seksi, ma i mençmi, ma ...i vetmumi! Pse s'më dooooo?!?!?!?; "Mshele, mshele, gruja duhet m'u mbyll!" - del kjo si piskamë ejakulimi nga ndoj seksist radikal!; "Kurv, kurv...!" - shpërthen dikush tip posesivi ndaj femnës, obsesiv e kompulsiv, thu ti ka doktoru mbi KURVININË! "Doktor kurvash" i kish shku titulli rrugaço shkencor psh! E kishin punësu edhe në universitet partitë tona politike biles! Pa konkurs...!

Sa shumë komente në Fb profilin tim pasi mbështeta lajmin kritik mbi një propagandë perverzist të formuluar kundër mbajtjes së maturës e që qarkulloi rrugëve të Çairit (si gjithmonë, pa çka!)!!!! I bij ballit shpull "taak", e them, oj nannnn sa shumë komente! Ndërsa unë me qetësinë e nirvanës i lexoj një nga njo! Ndonjëherë, bashkë me vajzën time ulemi dhe "fërc fërc fërc" lëvizim komentet! Të meremi vesh, kam një armatë lexuesish, biles sa të NATO-s, që më lexojnë me knaqësi e vëmendje e që ngrënë debat civili-

zues, me dakordime e mosdakordime e me argumente, ata që psh nuk më quajnë kudër, kaure, lopë o bullic ose trullajk! Janë të gjithë ata të cilët nuk e ndejnë nevojën të më bëjnë kualifikim racist ose tipizim grupor e të ushtrojnë seksisëm, sepse e dijnë mirë se unë duhem të kem bërë vetëvlerësimin e vetëkritikën me kohë apo! Janë ata që e ndejnë njëjtë si unë se diçka nuk është në rregull me trungun tonë kulturor, me shoqërinë e që bashkarisht përkojmë me e analizu për me gjet një formulë vazhdimi më të shëndoshë! Ndajmë brengën mik/mike, e e kemi më lehtë sëbashku tek e ndajmë! Veç a veç e ndamas na han ujku, na përbin aty për aty!

Të shkruarit është si një tip platforme që shtrohet pas një revolucion, ose ose, është një platformë e vazhdueshme e gjithërevolucionit të mendjes e brendisë njerzore! Platformë mendjeje, e atij lloj intimiteti që kërkon me dal me za e që të ç'virgjëron veten me miliona herë, është platformë mbi të cilën vihet kandvështrimi i sendeve e fenomeneve për t'u sqimu mëtej. Një shoqni pa shkrojtës, është e vdekun! I ka hy MORTJA e madhe mu n'lug asaj shoqnie! E kur shkruajnë ato që veshin take në kambë, takekuqet do

thoja- femnat pra, platforma bëhet ma vivide, ma gjallnuse, pritët ma me zhurmë! Tek e bëj këtë gjykim, që është intim e nuk është doemosdoshmërisht teorik, do thoni se po sfidoj me përbuzje gjininë tjetër kësisoj e se jam një femënfile kronike! Për më shumë keni të drejtë, unë jam femënfile kronike dhe la kryt pas femnave që guxojnë! La kryt pas vetes, i bje kjo gjithashtu! Unë e dua veten dhe e njoh deri në pjekurinë e vdekjes që vjen ngadalë! Sepse ti që më shan e përbuz me aq shovenizëm, kisha me të thanë se unë edhe vdekjen e kam pa me sy dhe nuk më është dukur e zezë! M'u duk e bardhë, sepse dijtat t'a pranoj si shpëtim të bardhë! Dmth, unë la kryt pas gjithë mikeshave të mia të cilat çajnë në jetë si luanesha! La kryt pas teme bije e cila bën luaninë bashkë me mua e çdo ditë! La kryt edhe pas bijës tënde o lexues, e do i kisha ndihmu t'a kuptojë lirinë me gjith mishin e shijes time Pa fuqinë e Lirisë individuale dhe Respektin ndaj saj, bija jote s'ka kuptim!!

Dikush nga ne luaneshat Femna e Gra shkruan, tjetra bën biznesin familjar, një e tretë rrit fëmijë e ngroh oxhak me dashni, një e katërt del lidere e shpall garrë për të drejta e liri, një e pestë është mjeke, tjetra

Ai muhabeti se përse shkruajmë ne që shkruajmë, kisha me pas thanë se është njësoj sikur të pyesësh vjedhësin se përse vjedh...! O e ka nga zanati e jo nga inati! Është vokacion, thirrje...! Kështu diçka do e kisha tentu...!

inxhinjere, tjetra mësuese, një e gjashtë është poete për të gjithë ne, njëra është njohëse e mrekullueshme e leximit fetar, tjetra gazetarë ...e secila nga ne është NANË e PERËNDESHË...! Secili që guxon të fikë zjarrin e këtyre luaneshave, kam bindjen se digjet në të! O bahet shkrum bre!

Çdo fushatë kundër guximit të mendjes së shëndoshë për ne femnat e këtyre damarëve, është insipirim e një dëshmi plus se kemi të drejtë në betejën tonë progresiste! Për më shumë miq e mikeshë, do vazhdoj të mendoj se në shoqërinë tonë shqiptare ka anakronizma të tipit perverz dhe secili nga ne që hesht para tyre, në fakt e lejon, pra e lavdëron marrëzinë! Një shoqëri që lavdëron marrëzinë, është rrugës për t'u shpallë e marrë! E si e marrë, s'ka se ku të mbështesë PLATFORMËN e MENDJES SË SHËNDOSHË! Sepse e shkatërron sistemin e mendjes së shëndoshë me vetëdorë! Një nga perverzionet e anakronizëm LUKUNIKE që e lejojmë të zhvillohet si kancer përmes heshtjes e indiferencës sonë ishte edhe propaganda anti festimit të mbremjes së maturës. Kur lavdëron marrëzinë, doemos që festimi i një nate mature do të të duket kataklizmik për një jetë njeriu. Ja se çka thonë propaguesit e antimaturës:

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koge | Data e shtypjes e martë 1 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

qenka nata kur humbet morali i motrave tona, qenka nata kur njerëzit e ligë fitojnë, qenka nata kur rinia jonë prishet, qenka nata kur prindi e dërgon vajzën e djalin në duart e shejtanit dhe punëtorëve të tij, qenka nata kur familja e humbet turpin brenda saj, qenka nata ku paratë e familjes bëhen shkak që fëmijët e tyre të prishen, qenka nata kur bëhet imoraliteti, kur humbet turpi i vajzës, humbet turpi i djalit...Që ky perversion të kap nivelin e një simulakrumi indoktrinues, këta propagues keqpërdorin fenë sepse thirren në autorësinë e Zotit vetë! E si të mos reagoj kundra kësjaj propagandë!?

Ndrësa hoxhallarët heshtin!? Dhe institucioni Bashkësi Fetare Islame hesht?! Në ndërkohë këta propagues interpretojnë mbrapsht Librin e Shenjtë!?! Për më shumë, thirren në të drejtë demokratike interpretative! Dorën në zemër, unë festoj festën e Bajramit e Ramazinit edhe pa fjalimin e Kryetarit të Bashkësisë Islame, por mua më duhet gjykimi i këtij institucioni mbi këtë propagandë që devijon leximin fetar TANI e KËTU! Përse hesht ky institucion?! A e ka të qartë ky institucion se kur duhet të bëjë misionin e vetë të shenjtë dhe se kur na duhet ndihma interpretuese nga ky kur kësi lloj propagandash janë fill !?

Nuk pres që të reagojnë partitë politike ndaj një propagandë kaq perverze sa kjo. Nuk shtë e para e s'do jetë as e fundmja, për me keq! Partitë tona politike shkatërruan arsimin e kulturën prandaj i kanë krijuar me vetëdorë hapësirë galaktike kësaj lloj subkulture e subarsimimi. Dhe as terti nuk iu bën veshi përfaqësuesve tanë politikë! Doemos që prisja të reagojë Bashkësia Fetare Islame ngase këta propagues propagojnë shtrembër ndërsa thiren në Librin e Shenjtë! Tanimë filloj të dyshoj se cili është në fakt roli i këtij institucioni!?! Mos ndoshta ky institucion ka depërtuar në dimenzionin e vetëhedonizmit korruptues dhe arsyeve veten duke sfiuar mes presidentësh e ambasadorësh !?

Po ç'lidhje ka BFI me politikën e diplomacinë o njerëz!!!! BFI duhet të jetë MBI politikën!!!! Përse ky institucion hesht para anakronizmave të këtilla që shtrembërojnë kulturën fetare ndër ne?!...Prandaj le hapet dhe ky debat miq, vetëm kështu mund të ndihmojmë bindjet tona të bëhen edhe më të fisme edhe më të mira! Mbi të gjitha pres që mendja e shëndoshë e njeriut të mos bie pre e propagandave banale, por të ngre rrezatimin se sa i edukojmë ne fëmijët tanë për një festim të civilizuar të maturës, pa shumë harxhime e pa shumë ekzaltim! Ky është debati që ngre mikja ime gazetare përmes shkrimit të saj në këtë gazetë ku shkruaj edhe unë! As më shumë e as më pak!

Dhe këtë debat e ngre një za femne përsëri! !!! NJIHE, pranoje, lartësoje!!!! Sepse ngre veten asisoj!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

Dogana ndëshkuese Amerikane, ora po afron!

Për BE dhe Gjermaninë do të ishte një goditje e fortë. 25% doganë për çelikut dhe 10% për aluminin. BE është prodhuesi i dytë më i madh në botë i çelikut—177 milionë tonë çelik prodhohen në vit. Gjermania ka SHBA si eksportuesin kryesor. Pas kësaj renditen Holanda, Italia, Spanja, Britania e Madhe e Suedia.

BËHET FJALË PËR MILIARDA

Sipas të dhënave të KE në vitin 2017 u eksportuan produkte të çelikut në vlerë prej 14 miliardë eurosh. 14% e të gjitha importeve të SHBA-së. Doganat e paralajmëruara nuk do të prekin të gjitha produktet. Më shumë do të preken produktet e çelikut, 5,3 miliardë euro dhe për aluminin 1,1 miliardë euro. Trump i argumenton doganat me tepricat tregtare europiane, sidomos ato gjermane. SHBA janë për Gjermaninë tregu më i madh i eksporteve. Përkundër kësaj nuk shiten shumë mallra amerikane në Europë. "Kemi një deficit tregtar me BE në vlerë, vështirë ta besosh, 151 miliardë dollarë", përsërit Donald trump. 50 miliardë në këtë shumë përbëjnë automjeteve dhe pjesët e këmbimit të tyre.

MË E KOMPLIKUAR SE MENDOHE

Automjetet gjermane janë të kërkuara në SHBA. 480.000 au-

tomjete në vit shiten në SHBA. Por prodhuesit gjermanë prodhojnë edhe në SHBA, e më shumë se sa importohet nga Gjermania në SHBA. 493.000 automjete gjermane në vit bëhen gati për eksport në Kinë. Me këtë punëdhënësit gjermanë ofrojnë dhe sigurojnë mjaft vende pune në SHBA. Drejtuesi i ifo-Zentrums për tregtinë me jashtë, Gabriel Felbermayer thotë këto vende pune rrezikohen me doganat e reja. "Po qe se amerikanët prodhojnë automjete, psh BMW në Spartanburg, për këtë ata kanë nevojë për mjaft komponentë, që vijnë nga Europa, dhe kur Trump kërcënon të vendosë dogana mbi këto, ai kërcënon apo shkatërron njëkohësisht edhe aftësinë konkurruese të prodhuesve amerikanë të automjeteve"; thotë ekonomisti.

TË GJITHË DO TË GODITESHIN

Në Gjermani çdo i katërti vend pune varet nga eksporti, në industrinë gjermane gati çdo i dyti. Më shumë se 50% e eksporteve gjermane lidhen me industrinë e përpunimit apo prodhimit të çelikut. Nuk ka çudi që Merkel ndërmori edhe një herë një përpjekje për të bindur Trumpin. Por ai nuk tha asgjë të qartë, se si do të vendosë. Të premtën Merkel telefonoi me presidentin francez, Emmanuel Macron dhe

kryeministren britanike, Theresa May. Të tre kërkuan edhe njëherë nga presidenti Trump të përjashtojë europianët nga masat tregtare kundër BE. Ndryshe edhe BE "është e gatshme të mbrojë interesat e saj në kuadër të rendit tregtar multilateral" tha zëdhënësi i qeverisë gjermane, Steffen Seibert.

PRODUKTET AMERIKANE QË SHITENJTOHEN

Në Bruksel janë bërë përgatitje për rastin më të keq. BE do të drejtohet me ankesë tek Organizata Botërore e Tregtisë. BE do të kishte 90 ditë kohë për "ribalancim", pra për kundërmasat e saj. Importet nga SHBA do të shtrenjtohen, që të kompensohej dëmi që i shkaktohet industrisë europiane.

Me doganat për whiskey-n apo motorët e markës Harley Davidson janë zgjedhur produkte që prodhohen në shtetet federale amerikane që qeverisen nga republikanët. Synimi është që guvernatorët e këtyre vendeve të bindin presidentin amerikan për të mos vendosur dogana.

A KA TREGTIA E LIRË NDONJË SHANS?

Në rast se grindja për tregtinë shkallëzohet, kjo nuk do të thotë se merr fund tregtia e lirë. Bisedimet në prapaskenë do të vazh-



Do t'i vendosë presidenti amerikan, Donald Trump doganat apo jo? Trump po i bën të dridhen europianët deri në minutën e fundit. Në grindjen për futjen e doganave ndëshkuese për çelikut dhe aluminin e importuar nga Europa, Trump ofroi një afat negociimi deri në 1 Maj. A do ta zgjasë ai këtë afat? Apo do t'i përjashtojë përfundimisht europianët nga doganat apo do t'i vendosë ato?

dojnë. "Në rast se ndodh kështu, do të vazhdojmë të punojmë në këtë çështje", thuhet nga zyra e kancelares. Nga pala gjermane ka përpjekje për të risjellë në tryezën e bisedimeve edhe një herë marrëveshjen e tregtisë së lirë, TTIP, por në një variant më të holluar. Mund të flitet në një kuadër më të madh për reduktimin e doganave dhe barrierave tregtare. Por sipërmarrësit nuk janë aq entuziastë për këtë. Presidenti i Shoqatës Gjermane të Industrisë, BDI, Dieter Kempf nuk është ndonjë përkrahës i madh i një marrëveshjeje për doganat. "Për industrinë gjermane kjo është shumë pak", ka thënë ai. (DW)

Mund të ndodhë që evropianët të mos shpëtojnë dot javët e ardhshme nga një konflikt i ashpër me qeverinë Trump, si në çështje tregtare, ashtu edhe në atë të Iranit

Disa gjëra që thotë Donald Trumpi për marrëdhëniet transatlantike janë thjesht absurde. Që NATO-ja u bën më shumë punë evropianëve se amerikanëve, siç u shpreh ai në vizitën e punës së kancelares në Uashington, është për shembull një pohim i diskutueshëm. Aleanca perëndimore u afron Shteteve të Bashkuara prej vitesh qasje strategjike ndaj Evropës, njëri nga rajonet më të rëndësishme të politikës botërore. Po të mos ishte kështu, nga NATO-ja do të kishin hequr dorë që paraardhësit e Trumpit. Por Presidenti ka të

Trumpi dhe modeli gjerman



drejtë kur u kujton tani gjermanëve se një aleancë kërkon një ndarje në njëfarë mënyrë korrekte të barrës. Merkeli e pranoi këtë në Uashington. Pyetja e madhe që shtrohet është nëse qeveria federale do t'i pasojë këto fjalë me shumë vepra se deri tani.

Trumpin shumë qytetarë dhe politikanë e përjetojnë si fyerje, në mos si rrezik për stabilitetin e botës. Këto shqetësime janë padyshim të justifikuar po të shohësh stilin nationalist, impul-

siv dhe të dashuruar me veten të Presidentit. Por përballë Gjermanisë, Trumpi megjithatë rimerr një kritikë, të cilën e kanë shprehur para tij edhe partnerët tjerë të vendit tonë. Pozicioni i Gjermanisë në botë karakterizohet prej shumë vitesh nga dy zhvillime, të cilat çojnë automatikisht në konflikte me aleatët: përmbajtja ushtarake dhe tepricat e mëdha në eksporte. Që në BE kjo ka çuar herë pas here në iritime, jo së fundi në Francë. Në

Evropë Gjermania është aq e fortë sa ta imponojë modelin e saj. Përballë Amerikës që vazhdon të jetë shumë e fuqishme puna bëhet më e vështirë, edhe sepse nuk ka më një interes të përbashkët sipëror si në kohët e Luftës së Ftohtë.

Mund të ndodhë që evropianët të mos shpëtojnë dot në një kohë të afërt nga një konflikt i ashpër me qeverinë Trump, si në politikën tregtare, ashtu edhe në çështjen e Iranit. Por pavarësisht nga kjo, është në interesin e mirëfillt gjerman që ta bëjmë më pak të sulmueshëm modelin tonë. Një fuqi ekonomike e mesme duhet ta garantojë sa të jetë e mundur më shumë vetë mbrojtjen e saj. Dhe kriza financiare ka treguar se investimi i kursimeve gjermane në botën e jashtme (kjo është ana tjetër e medaljes e tepricave në eksport), nuk është gjithmonë ide e mirë. Këtu janë kantieret e vërteta të ndërtimit të koalicionit. (FAZ)



A e dini pse zëri ynë tingëllon ndryshe i incizuar?

Shumicës prej nesh, nuk na pëlqen zëri ynë kur e dëgjojmë në ndonjë audio apo video të incizuar. Zëri ynë i incizuar na tingëllon shumë më ndryshe sesa kur flasim në të vërtetë, gjë që na bën që shpesh ta "urrejmë" atë. Por, për gjithë këtë ekziston një arsye. Arsyeja pse e urrejmë zërin tonë të incizuar është për shkak se kafa jonë e ndryshon rezonancën e zërit tonë nga brenda dhe krijon më shumë bas. Kur e dëgjojmë një incizim digjital të zërit tonë, edhe pse na duket shumë më ndryshe, në fakt ai është saktësisht ashtu siç e dëgjojmë njerëzit e tjerë kur ne flasim.



Kujdes me zgarën, tymi konsiderohet fatal!

Sipas hulumtimeve të fundit, thuhet se të bërit grill, ka rreziqe të helmimit nga monoksidi i karbonit (CO). Studimi bazohet në sondazhin e fundit ku thuhet se katër në pesë britanikë, nuk dinë ende rreziqet që mund të sjell një ushqim i tymosur në ambient të hapur. Këto statistika po cilësohen si alarmante, pasi njerëzit përveç një fakti të tillë që nuk kanë ditur, ata dinë rreziqe të tjera nga grilli, të tilla si helmimi në ushqim, siguria nga mosdjegia e fëmijëve, zjarri në kopsht, aksidente nga dehja por jo, rrezikun vdekjeprurës nga tymi. Gjithashtu thuhet se britanikët janë aq të shqetësuar për dëmet e mundshme të bimëve të tyre të kopshtit të shkaktuara nga një grill, pasi ata janë duke u ekspozuar ndaj gazit CO. Nga ky hulumtim, apelohet se kurrë nuk duhet të përdorni një Barbecue brenda ose në një tendë ose karavan, pasi tymi mund të jetë fatal në një hapësirë të mbyllur. Kjo vjen pasi gjysma e britanikëve planifikon të ketë një grill për familjen dhe miqtë një mesatare prej pesë herë këtë vit.

Kur bëhet fjalë për pastrimin e shtëpisë, të gjithë mendojnë të zgjedhim produktet më të mira larëse pasi mendojmë se vetëm kështu do të sigurojmë higjienën e duhur

Harxhojmë shifra të konsiderueshme duke blerë detergjente të posaçme për çdo kënd të shtëpisë si kuzhina, dhoma e ndenjes, larës për sobën, frigoriferin dhe për banjën. Por, uthulla e bardhë e rrushtit është ajo që nuk duhet të mungojë kurrë jo vetëm në hapësirën e kuzhinës, por edhe në banjë. Ajo shërben për të larë pothuaj të gjitha pajisjet hidro-sanitare, duke filluar nga WC, vaska, kabina e dushit, deri te dritaret dhe rubinetët që duken gjithmonë të pisët dhe me shenja uji.

TUALETI: Për të pastruar tualetin mjafton që të derdhni në gjithë sipërfaqen e tij uthull rrushti dhe ta lini të veprojë për 15-20 minuta, më pas fërkojeni me furçë dhe lajeni me ujë të bollshëm.

VASKA: Vaska është një



PRODUKTI USHQIMOR QË ZËVENDËSON DETERGJENTET

ndër ato objekte që duhet pastruar vazhdimisht dhe i duhet ndërruar uji pas çdo larjeje pasi në këtë mënyrë bëhet i mundur dizinfektimi i saj. Por nuk mjafton me kaq pasi patogjenët agresivë dhe bakteret e ndryshme mbesin sërish brenda saj. Për t'i rikthyer pastërtinë dhe shkëlqimin mjafton të shtoni në një enë 1 gotë uthull të bardhë rrushti dhe 2 lugë sodë

buke. Treteni masën në një kovë ose legen me ujë dhe pastroni gjithë sipërfaqen e saj me ndihmën e një sfungjeri.

RUBINETI: Edhe pse mamatë ju porosisin të pastroni kokën e dushit dhe rubinetin pasi bëni banjën, ju vazhdoni të mos e ndiqni këshillën e saj. Si rrjedhojë rubineti duket i pisët, plot njolla dhe mbi të gjitha vazhdon të akumulojë baktere. Për të mos thënë që

nëse keni provuar ta lani me acid banjoje, ai ndryshon dhe ngjyrë. Zgjidhja është fare e thjeshtë, krijoni një solucion larës me uthull të bardhë rrushti, sodë buke dhe kripë të bardhë. Hidhni në një shishe bosh në trajtë sprucatori. Fërkonin rubinetin me të dhe lëreni të veprojë për një orë. Në fund fshijeni me leckë pambuku. Do të habiteni nga rezultati.

Smartphonet shkëpusin prindërit nga fëmijët

Sipas një studimi të Brandon McDaniel, profesor në Illinois State Universit, botuar në revistën Child Development, nëse prindërit kalojnë shumë kohë me përdorimin e Smartphone-ve, fëmijët e tyre mund të manifestojnë probleme karakteriale, të sjelljes, kapricio, shqetësime e deri në hiperaktivitet. Ekspertët amerikanë studiuan 170 familje me fëmijë të vegjël, duke i pyetur prindërit respektiv në lidhje me marrëdhënien që ki-



shin ata me teknologjinë dhe Smartphone-t në veçanti, si dhe masën e ndikimit të këtyre marrëdhënieve në raport me

fëmijët. Më shumë se gjysma e të intervistuarve deklaruan se Smartphone-t dhe dispozitivë të tjerë, ndërprisnin raportin me fëmijët së paku tre herë në ditë, kur ata i përgjigjeshin email-eve, mesazheve, apo chat-ve me të tjerë. Doli se ekzistonte një marrëdhënie në linjë të drejtë mes problemeve në sjellje që manifestonin fëmijët dhe frekuencës së përdorimit të Smartphone-ve dhe teknologjive të tjera, gjatë aktivitetit në familje.

Vetëm një filter i çajit dhe ju nuk do të keni më në shtëpi minj e merimanga



Minjtë dhe infeksionet e merimangave janë probleme që i shqetësojnë me mijëra familje anembanë botës. Një numër i madhe i familjeve zgjedhin ndihmën profesionale për t'u liruar një herë e përgjithmonë, por në fakt kjo ndihmë profesionale edhe kushton shumë shtrenjtë dhe merr shumë kohë deri sa të largohen përgjithmonë. Kjo janë arsye se pse njerëzit po kërkojnë alternativa tjera më të lehta dhe më të shpejta. Ekziston një teknikë shumë e lehtë dhe

shumë efektive e cila do të ju ndihmojë që t'i eliminoni shumë shpejtë. Falë kësaj teknikë që është përdorur për qindra vjet, ju për një kohë të gjatë nuk do të shihni minj dhe merimanga në shtëpinë tuaj. Mundet të ju duket e çuditshme, por juve ju duhet vetëm një filter çaj mente. Ju mundeni të vini re efektin e këtij filteri për vetëm 2 deri në 3 ditë dhe efekti i tyre do të zgjasë me muaj apo edhe vite.

NDIQNI UDHËZIMET: Merrni ca filtera çaj mente dhe futni në

ujë të ngrohtë. Pastaj merrni filterat dhe i vini në vendet ku i keni vërejtur minjtë apo merimangat. Është mirë që të vendosen në çdo cep të shtëpisë. Një alternativë tjetër është përdorimi i vajit aromatizues i mentës. Mbushni një shishe spërkatëse me ujë dhe shtoni 10 deri në 15 pika nga ky vaj aromatizues dhe spërkatni rreth e çark shtëpisë suaj. Por për t'i hequr merimangat ju mundeni të përdorni edhe vaj limoni me kanelë.

Sir Seretse Khama u dashurua me britaniken Ruth Williams. Seretse ishte një student i edukuar në Oksford, princi i familjes mbretërore të asaj që njihet si Beuanaland, një protektorat britanik

ROMANCA QË TRONDITI EVROPËN, AFRIKËN DHE "RRËZOI" NJË MBRETËRI



Afrika e Jugut ishte gati për të prezantuar politikën e apartejdit dhe martesën e një britanikeje me një afrikan, do të shkaktonte një krizë kushtetuese dhe brenda Komonuelthit. Një zyrtar nuk pranoi t'i martonte dhe ata e bënë këtë gjë në fshehtësi



Historia e jashtëzakonshme e dashurisë mes presidentit të parë të Botsvanës me një angleze të bardhë të klasës së mesme, zgjati, pavarësisht pengesave dhe zemërim.

Sir Seretse Khama u dashurua me britaniken Ruth Williams. Seretse ishte një student i edukuar në Oksford, princi i familjes mbretërore të asaj që njihet si Beuanaland, një protektorat britanik. Në vitin 1948, në moshën 27-vjeçare, ai u martua me britaniken Ruth, 24 vjeç, punonjëse në një agjenci sigurimesh. Martesa e tyre u kundërshtua me forcë nga babai i saj dhe familja e atij.

Ai ishte princi i një tribuje dhe ishte dërguar në Londër nga xhaxhai i tij për të studiuar për juridik.

Pasi të mbaronte studimet, duhej të kthehej në vendlindje për t'u martuar me një vajzë nga fisi. Qeveria britanike dhe xhaxhai i tij bashkuan forcat për të kërkuar nga Seretse që të heqë dorë nga gruaja e tij e bardhë, ose të heqë dorë nga kurora. Ruth Williams ishte vajza e një ish-kapiteni të ushtrisë indiane, që punoi më vonë në tregtinë e çajit.

Ajo pëlqente muzikën xhaz, ai po ashtu. Të dy u takuan kur motra e Ruth, Muriel, e mori atë në një mbrëmje vallëzimi në vitin 1947.

Seretse i kërkoi të kërcenin dhe aty nisi romanca. Ishte një histori e jashtëzakonshme pasioni. Ruth duhej të kërkonte nga babai i saj leje për martesën, por ai refuzoi që ajo të martohej me një person me ngjyrë. Ajo nuk e kishte menduar kurrë se historia e saj do shkaktonte një tërmet të tillë, deri në pikën kur një zyrtar i shkoi në zyrë dhe i tha: "Nëse e bën këtë gjë, do të rrëzosh perandorinë britanike në Afrikë".

Duket e çuditshme, por ishte tamam kështu. Afrika e Jugut ishte gati për të prezantuar politikën e apartejdit dhe martesën e një britanikeje me një afrikan, do të shkaktonte një krizë kushtetuese dhe brenda Komonuelthit. Një zyrtar nuk pranoi t'i martonte dhe ata e bënë këtë gjë në fshehtësi. Të dy u larguan drejt Afrikës, duke menduar se gjërat ishin zgjidhur.

Por xhaxhai i tij, Shefi Tshekedi mbledhi këshillin e të moshuarve të fisit dhe deklaruan se nuk e njohin Ruth-in si mbretëreshë të fisit. Seretse dhe mbështetësit e tij e kuptuan se xhaxhai i tij, Tsheke-

di, në fakt donte të bëhej mbret. Kryeministri i Afrikës së Jugut vazhdonte i tërbuar. Ai tha se kjo martesë është e neveritshme.

Me gruan e tij shtatzënë, Seretse u ftua për në Londër. Ruth mbeti në Afrikë. Ishte një kurth. Britanikët insistuan që ai të heqë dorë nga fronin.

Kur refuzoi, i thanë se nuk do e lejonin të kthehej në vendlindjen e tij. Mbështetësit e Seretse formuan një komitet dhe i dërguan një letër Mbretëreshës, duke i kërkuar që të lejojë 'shëfin' e tyre të kthehej. Seretse u kthye, por hoqi dorë nga fronin. Në fakt, ai mbajti të parat

zgjedhje demokratike në vend dhe u votua presidenti i asaj që u bë shteti i Botsvanës. Çifti ka një vajzë dhe tre djem. Njëri prej tyre u bë president i Botsvanës. Seretse vdiq në krahët e gruas në moshën 59-vjeçare. Ajo vdiq në moshën 78-vjeçare në vitin 2002.

LAURENE POWELL, jeta e vetme e gruas së Stiv Jobs



Vlera e aksioneve të saj në 'Disney' është trefishuar që prej vdekjes së bashkëshortit të saj dhe përbën pjesën më të madhe të pasurisë së Powell Jobs-it, meqë edhe është aksionarja më e madhe individuale në këtë kompani

Shtatë vjet pasi Stiv Jobs u largua përgjithmonë, jeta e Laurene Powell nuk është më e njëjtë. Biondja që i rrëmbeu zemrën menjëherë Jobs në auditorët e Universitetit të Stenfordit, tashmë ka nisur një jetë tjetër, duke ia lënë të shkuarën kujtimeve. Mediat tregojnë herë pas here imazhe të udhëtimeve që ajo po bën bashkë me të dashurin e ri, ish-kryebashkiakun e Uashingtonit, Adrian Fenty.

Ajo duket e bukur dhe e qetë, pas trishtimit të gjatë që i solli ndarja nga jeta e burrit me të cilin ndau një pjesë të rëndësishme të jetës. Por Laurene nuk ka dashur asnjëherë të ndajë kujtimet me të tjerë, duke i ruajtur për vete kohët kur kishte pranë burrin që revolucionarizoi shoqërinë. Powell ka lin-

dur në vitin 1963. Nëna e saj ishte mësuese ndërsa babai pilot marine. Babai i saj vdiq në një aksident me aeroplan kur ajo ishte tre vjeç dhe nëna e saj më vonë u martua përsëri.

Ajo u diplomua në fushën e biznesit dhe të ekonomisë në Universitetin e Pensilvanisë. Powell Jobs nisi të punojë në 'Wall Street' për 'Merrill Lynch' dhe 'Goldman Sachs', para se të fillonte "aventurën" e saj në Shkollën e Biznesit në Universitetin e Stenfordit në vitin 1989. Pikërisht gjatë studimeve të saj në Stenford ajo u njoh me Steve Jobs-in. Ishin të dy të ulur pranë në një ligjëratë, dhe Jobs do të tërhiqej menjëherë nga vajza bionde, duke mos humbur rastin për ta ftuar për darkë. Në atë mbrëmje ndryshoi gjithçka.

Çifti do të martohej më mars të vitit 1991 në Hotelin 'Ahwahnee'. Ata kanë sjellë në jetë tre fëmijë: Reed-in, Erin-in dhe Eve-n. Më e vogla, Eve, do të shkojë në kolegji në vjeshtë, duke e lënë të vetmuar nënën e saj. Pas ndarjes nga jeta të Jobs, ajo trashëgoi 5.5 milionë ak-



sione në 'Apple' dhe 7.3 për qind të aksioneve në Kompaninë 'Walt Disney', pasuri kjo që e kishte bërë atë miliardere. Me një pasuri të përgjithshme prej 13.1 miliardë eurosh, Powell Jobs është femra e katërt më e pasur në botë. Por pas ikjes që Jobs ajo nuk qëndroi pasive.

Vlera e aksioneve të saj në 'Disney' është trefishuar që prej vdekjes së bashkëshortit të saj dhe përbën pjesën më të madhe të pasurisë së Powell Jobs-it, meqë edhe është aksionarja më e madhe individuale në këtë kompani. Përkundër faktit që ishte martuar me njërin prej njerëzve më me ndikim në Luginën e Siliconit, Powell Jobs asnjëherë nuk kishte qëndruar pasive, për t'u varur vetëm nga bashkëshorti i saj.



HARADINAJ: KUSHTET JANË TË PAFAVORSHME PËR GJETJEN E POLICËVE

U raportua se Posta e Kosovës ka arritur të kap ca sinjale telefonike afër malit ku dyshohet se ka ndodhur aksidenti, që nuk dihet se të kujt janë, por në një prononcim për Gazetën Express, zëdhënësi i PK'së nga rajoni i Ferizajt, Agim Gashi, ka thënë se do të japin detaje për çdo gjë që do të ketë të re rreth kësaj çështjeje.

Në ditën e tretë kur dy policë të Kosovës vazhdojnë të mbesin të zhdukur pas aksidentit që kanë pësuar në rrugën Hani i Elezit-Kaçanik, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj ka treguar se kanë shtuar numrin e personalet që janë duke i kërkuar policët e zhdukur.

Haradinaj ka theksuar edhe njëherë vështirësitë që po përballën për t'i gjetur dy pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Ka thënë se kushtet janë të pafavorshme për gjetjen e policëve për shkak të lartësisë së madhe si për shkak të lumit të rrëmbyeshëm.

"Nuk ka diçka të re ende, kërkimet janë intensifikuar, atje kam qenë vetë dhe kemi shtuar numrin e personalit aktiv, mirëpo rrethanat janë tejet të pafavorshme për shkak se lartësia nga kanë rënë po-

licët është shumë e madhe dhe vetëvetiu gjendja e trupave nuk mund të jetë e lehtë identifikuar por edhe lumi i rrëmbyeshëm", ka deklaruar kryeministri, shkruan Insajderi.

Ai më tej ka thënë se ende nuk ka bërë një kërkesë zyrtare për kërkimin e policëve nga territori i Maqedonisë, ka thënë se një kërkesë të tillë do ta bëjë pasi të përmbyllen kërkimet në territorin e Kosovës.

"Por në momentin që ta përmbyllim në territorin e Kosovës unë ende nuk i kam bërë kërkesë zyrtare Maqedonisë, për kërkime atje por ma shumë kam bërë kërkesë miqësore që të interesohen, kur të mbyllën kërkimet në Kosovë do ta bëjë një kërkesë zyrtare edhe nga ana e Maqedonisë".

"Do të ju qëndrojmë afër fa-

miljes së policëve si Qeveri dhe si shtet nuk do të turpërohem nga policët të cilët më të vërtetë po kryejnë punë të madhe në vendin tonë", ka deklaruar Haradinaj.

Ndërkohë, ekipet e shpëtimit të FSK'së, bashkë me njësitet e zjarrfikësve kanë nisur mëngjesin e tretë të operacionit kërkues për gjetjen e dy policëve të zhdukur pas një aksidenti të së shtunës mbrëma në magjistralen Kaçanik-Hani i Elezit.

U raportua se Posta e Kosovës ka arritur të kap ca sinjale telefonike afër malit ku dyshohet se ka ndodhur aksidenti, që nuk dihet se të kujt janë, por zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Ferizajt, Agim Gashi tha se "nuk i komentoj shkrimet e portaleve, vetëm mundem me konstatu-

dhe me informu se hetimet dhe kërkimet për dy pjesëtarët e Policisë së Kosovës janë duke vazhduar me intensitet edhe më të madh".

Sipas tij, në kërkime po marrin pjesë 170 pjesëtarë të agjencioneve të ndryshme.

"Kemi 170 pjesëtarë të agjencioneve të ndryshme në teren që janë duke bërë kërkime. Për çdo risi, për çdo informatë tjetër sa i përket rastit do të njoftoheni me kohë", ka thënë ai. "Hetimet janë duke vazhduar, gjithçka e re do të tregohet nga ana e jonë, në momentin që hasim në risi", tha ai.

Malësor Dashi dhe Armend Trena, të dytë policë të stacionit të Kaçanikut, dyshohet se me veturën e tyre zyrtare, derisa po udhëtonin nga Hani i Elezit në Kaçanik, kanë rënë në lumin Lepenc.



"Kurir" zbulon një "grup kriminal shqiptar" në futbollin serb

Në Serbi raportohet një lajm i bujshëm, por a është i vërtetë apo jo, kjo mbetet për t'u parë. "Kurir" shkruan se familja Osmani, e njohur për aktivitetin e saj kriminal në Ballkan dhe thuajse në të gjithë Europën Perëndimore, po pastron para në futbollin serb dhe jo vetëm kaq, por edhe e kontrollojnë atë. Sikurse raportohet në artikullin e gazetës serbe, shërbimet sekrete po punojnë për të zbuluar pastrimin e parave në një klub serb, duke komanduar transferimet. "Kurir" pretendon se do të zbulojë edhe detaje të tjera të gjithë këtij aktiviteti kriminal. Sikurse thuhet në artikull, klani Osman, me paratë e fituara nga tregtia e drogës dhe e armëve, komandon gjithçka në futbollin serb, teksa tanimë po përdor edhe transferimet e lojtarëve. Pritet që në vijim të zbulohen edhe emrat e menaxherëve që e kanë përfshirë këtë grup kriminal në këtë valle, si dhe emri i klubit që ata përdorin. Por në faqen e parë të Kurir shihet edhe fotoja e Falji Ramadanit, menaxher që në Serbi ka bërë lëvizje të shumta. Nëse kontrollon online, përmenden edhe lidhjet e këtij menaxheri me familjen Osmani, teksa Burim dhe Bashkim Osmani cilësohen si partnerët e tij strategjikë. Në Serbi prej kohësh e kanë shprehur habinë se si mediat nuk shkruajnë keq për Ramadanin dhe ajo që i habit më së shumti ka të bëjë me faktin se si ai ka ecur kaq shumë, kur lidhjet me futbollin në shkuarën kanë qenë thuajse zero. Mbetet për t'u parë se çfarë do të zbulojë më tej "Kurir", që njihet edhe për shkrimet e saj nacionaliste.

Kosovë, caktohet kryeprokurori i Speciales

Pas largimit të David Schëediman nga pozita e krye prokurorit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Kosovë, një tjetër amerikan është caktuar të udhëheq me këtë institucion. Kryeprokurori i ri i Prokurorisë Speciale, pritet të jetë prokurori amerikan, Jack Smith. Ai ka përvojë edhe nga e kaluara në

prokuroritë jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pasi ka shërbyer për një kohë edhe në Sudan. Prokurori amerikan, 48 vjeçar, thuhet të ketë kërkuar rreth një vit kohë për t'u familjarizuar me procedurën dhe lëndët që do të trajtojnë Specialja.

Fillimisht mendohej se kryeprokuror do të caktohej Këai Hong

Ip, në mënyrë që ta sigurojë vazhdimësinë dhe ta ruajë ritmin e hetimeve, shkruan gazetametro.net. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale për krime lufte, David Schëendiman është larguar nga detyra në shkurt të këtij viti. Ai përmes një komunikate me shkrim kishte treguar se është larguar nga detyra për shkak të skadimit të



emërimit të tij për afatin e caktuar për tre vite si një Officer i Lartë për Shërbim të Jashtëm në Departamentin Amerikan të Shtetit.



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se raportet me Turqinë nuk përbëjnë asnjë lloj

Rama: S'ka rrezik nga Turqia

kërcënimi. Në një intervistë për "Ora News", Rama, duke komentuar deklaratat e David Phillips, ekspert i politikës së jashtme në SHBA dhe drejtor i programit për ndërtimin e paqes dhe të drejtat e njeriut, i cili në një intervistë të disa ditëve më parë për Zërin e Amerikës është shprehur se Shqipëria duhet të merr seriozisht kërcënimet ndaj sovranitetit që vijnë nga Rusia

dhe Turqia, ka thënë se ka marrëdhënie shumë pozitive me profesorin ndërsa tha se nuk ka çfarë të zgjedh mes këtyre të dyjave.

"Unë do zgjidhja një kafe me profesorin dhe ta diskutoj me të se sa larg është profesori me këtë përshkrim të realitetit që nuk ka asnjë lidhje me realitetin. Nëse do i merrnim me radhë", ka thënë ai.

"Së pari, unë nuk i kërkoj leje dhe nuk i jap llogari asnjë profesori dhe asnjë tjetri se në cilat dasma shkoj, por unë nuk kërcej nëpër dasma. Nuk kam kërcyer ndonjëherë se për fat të keq nuk e kam atë talent. Së dyti, jam ndjerë i nderuar që presidenti më ka ftuar në dasmën e të bijës. Së treti, marrëdhëniet tona me Turqinë nuk përbëjnë në asnjë rast, jo kërcënim të sovranitetit

dhe asnjë lloj kushtëzimi dhe profesori, që është një njohës jo i keq i çështjeve të rajonit, duhet ta mbajë mend që Turqia ka qenë i pari vend që ka njohur Kosovën e pavarur. Dhe deklarimi i pavarësisë në parlamentin e Kosovës është ndjekur nga qeveria turke dhe kryeministri i atëherëshëm, presidenti i sotëm i Turqisë live në tryezën e qeverisë, në momentin që kur të deklarohet pavarësia, të ngrihet dora për të njohur Kosovën", ka thënë Rama.

Si jetojnë njerëzit sot në Siri, shtatë vjet pas fillimit të luftës? Si duket jeta e përditshme? Frustrimet, frika, mungesa e shpresës dhe perspektivës...



SHTATË VJET LUFTË: SI DUKET JETA E PËRDITSHME NË SIRI?

"Para shpërthimit të luftës fitoja rreth 700 lira siriane në muaj dhe isha i kënaqur. Tani fitoj 10.000 lira në ditë dhe nuk mjaftojnë. Kam humbur besimin tek ekonomia vendore", thotë Sameri, një taksist në Damask. Ai ka ikur nga vendlindja e tij, Qodsiye dhe ka ardhur në kryeqytet.

NUK KA PARA PËR USHQIME

Prej fillimit të luftës civile në Siri, vlera e lirës siriane ka rënë me 90%. Përveç kësaj, shumë gjëra të nevojshme për jetën e përditshme nuk mund të gjenden fare, gjë që ka ndikuar në rritjen e madhe të çmimeve. Ndaj shumë sirianë janë të detyruar të kursejnë. Madje edhe gatimet janë shndërruar në gjëra luksoze. "Kam filluar të shfrytëzoj orizin dhe ushqimet e kualitetit të dobët. Aktualisht ha mish vetëm njëherë në muaj", thotë Jasmína, një grua e moshës 40-vjeçare, nënë e tre fëmijëve.

Ajo ka vështirësi të paguajë edhe qeranë për apartamentin në Damask, ku ka ardhur pas shpërthimit të luftës në vendlindjen e saj. "Më mirë të hash ushqim të keq sesa të jetosh në rrugë", thotë ajo. Por jo të gjithë mendojnë për ushqimet, sikurse duket nga një shikim në restorante apo kafene. Tani ka më shumë restorante se para luftës. "Të kursesh? Deri kur? Deri sa nuk kam vdekur? Jo, ne jetojmë vetëm njëherë", thotë Taimi. "Nuk dua të flas për politikën, shkoj në dëfrime, pi votkë të lirë dhe kënaqem duke vallëzuar me miq". 23-vjeçari rregullisht poston video në Facebook.

Një prej këtyre vendeve është edhe bar Mazzika, në qendër të Damaskut. Taimi me shokë rri këtu deri në orët e para të mëngjesit,

kur kthehet në shtëpi me makinë. "Është rrezik, por frika me kohë zvogëlohet. Mësohesh dikur me frikën". Taimi qesh pas gati çdo fjali. Mbase kjo është mënyra për të injoruar vizionin apokaliptik të një të ardhme të errët.

ZHDUKJA E PROFESIONEVE

Prej fillimit të luftës, nuk ka më të dhëna të sakta për gjendjen ekonomike. Por një është e qartë: profesione të tëra industriale janë zhdukur në tërësi. Dyqanet e mobilieve janë mbyllur. Nuk ka më as agjenci turistike dhe turizëm. Ndërsa lulëzon ekonomia ilegale. Kontrabanduesit transportojnë mallra në vijat e luftimeve dhe i shesin me çmime tepër të larta. Ata u japin ryshfet palëve dhe kalojnë nëpër linjat e luftimeve.

Prej fillimit të luftës civile në Siri, vlera e lirës siriane ka rënë me 90%. Qeveria e Sirisë po përpiket që të përhapë lajme pozitive: "Ek-



sporti i ilaçeve nga Siria po rritet. Katër laboratorë kanë marrë leje pune në vitin 2017", shkruan gazeta qeveritare Al-Thawra. Të rinjtë megjithatë po përpiqen jo vetëm të mbijetojnë në këtë kohë, por edhe të punojnë. Ata kanë hapur edhe sipërmarrjet e tyre. "Hapja e

sipërmarrjeve po ndodh së fundi në Damask, Aleppo dhe Homs. Kjo lejohet vetëm nëse siguron buri- met e duhura financiare", thotë Maen Elhemme. Ai mendon se aktualisht në gjithë Sirinë ka rreth 500 start-up. Problemi i bizneseve të reja është mungesa e struk-

turës juridike në Siri. "Garancitë për sukses janë shumë të vogla", thotë Elhemme.

SHANSI PËR FEMRAT

Prej fillimit të luftës nga Siria janë larguar shumë akademikë. Kjo është humbje e madhe për ekonominë e vendit, por edhe një shans i ri. "Shumë sirianë kanë shkuar në Evropë, e një pjesë e tyre kanë mundësinë e përparimit në profesion", pohon Elhemme. "Kur të përmirësohet gjendja në Siri, ata mund të kthehen dhe të përdorin njohuritë e marra në Gjermani".

Femrat në Siri kanë filluar ndërkohë të punojnë në shumë profesione, të cilat më parë janë konsideruar si profesione meshkujsh. Gazeta Al-Ayyam shkruan se 58,3% e fermave punojnë në punë të cilat më parë i kanë bërë meshkujt. Por këto të dhëna nuk janë përfshirë në statistikat zyrtare.

Femrat në qytetin Tartous punojnë si shitëse në rrugë, ngasin autobusë apo punojnë si automekanike. Në Damask ka femra që punojnë edhe si taksiste, që është një fenomen i ri. Shumë burra kanë ikur nga vendi apo janë futur në burgje. Ndaj shumë femra duhet të kujdesen për familjet. A do të ndikojë e gjitha kjo në përmirësimin e pozitës së femrave pas luftës, nuk është e sigurt.

"LUFTA" NË DUART E NETANYAHUT

Parlamenti i Izraelit (Knesset) ka miratuar projektligjin i cili i jep autoritet kryeministrit Benjamin Netanyahu që të shpallë luftë pas konsultimit me ministrin e Mbrojtjes. Sipas lajmit të gazetës "Haaretz" theksohet se është miratuar në votimin e dytë dhe të tretë projektligji në fjalë i cili i jep autoritet kryeministrit izraelit që në situata të

jashtëzakonshme të shpallë luftë pas konsultimit me ministrin e Mbrojtjes. Në lajm nuk është dhënë informacion në lidhje me numrin e deputetëve që kanë votuar në favor të ligjit. Me ligjin në fjalë Netanyahu nuk do të jetë më i detyruar që të marrë miratimin e qeverisë apo të komisionit të çështjeve të sigurisë dhe politike të Knesset për të shpallur luftë.

IRANI KA PROGRAM SEKRET TË ARMËVE BËRTHAMORE!

"Irani vazhdon një program dinamik dhe sekret të armëve bërthamore. Këtë është përpjekur ta fshehtë nga bota dhe populli i tij, por nuk ka arritur", deklaroi zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders



Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders, deklaroi se Irani është duke vazhduar një program dinamik dhe sekret të armëve bërthamore dhe se këtë gjë është përpjekur ta fshehtë nga bota, por nuk ka arritur. Këto komente Sanders i bëri në një deklaratë me shkrim në lidhje me konferencën e djeshme për shtyp të kryeministrit izraelit Benjamin Ne-

tanyahu, i cili ka deklaruar se Izraeli ka informacione rreth programit bërthamor të Iranit. Ajo tha se janë të vetëdijshëm në lidhje me procesin bërthamor të Iranit dhe se po ndjekin nga afër çështjen e informacioneve dhe dokumenteve të pretenduara nga Izraeli. "Kjo situatë vërteton faktin që SHBA-ja e di prej shumë kohësh: Irani vazhdon një program dinamik dhe sek-

ret të armëve bërthamore. Këtë është përpjekur ta fshehtë nga bota dhe populli i tij, por nuk ka arritur", deklaroi Sanders. "Regjimi iranian ka treguar se do të përdorë armë destruktive kundër fqinjëve të tij dhe vendeve të tjera. Kjo është arsyeja pse Irani kurrë nuk duhet të posedojë armë bërthamore", ka komentuar Sanders. Ndryshe, kryeministri izraelit Benjamin Ne-

tanyahu në një deklartë në Tel Aviv në lidhje me programin bërthamor të Iranit ishte shprehur se inteligjenca izraelite ka siguruar "një informacion të fshehtë prej 55 mijë faqesh të arkivuara në 183 CD rreth programit bërthamor të Iranit".

Gjithashtu, edhe Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo në një deklaratë me shkrim në lidhje me deklaratat e Netanyahu

për Iranin kishte theksuar se dokumentet në fjalë kanë treguar se "Irani ka vazhduar për vite me radhë programin e armëve bërthamore". Irani ka vazhduar zhvillimin e armëve bërthamore dhe sistemit raketor. Irani deri më sot ka fshehur nga bota dhe nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike një arkivë të madhe atomike, ka thënë Pompeo.

QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015; 39/2016 dhe 64/2018), dhe në pajtim me Vendimin për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e Drejtorit të NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" nr. 08 - 3737/1 të datës 27.04.2018, Kryetari i Qytetit të Shkupit, shpall:

KONKURS PUBLIK
për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike
"Ujësjellësi dhe kanalizimi" – Shkup

- Kandidatët për zgjedhjen e drejtorit duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - të jenë nënshtruar të Republikës së Maqedonisë;
 - të posedojnë së paku 240 kredi sipas EKTS ose të kenë përfunduar nivelin VII/1 të arsimit;
 - në momentin e emërimit, me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - të posedojnë së paku pesë vite të përvojës së punës;
 - të posedojnë një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare ose të vërtetimeve për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetra se pesë vite, me sa vijon: TOEFEL IBT (TOEFL iBT) – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE Cambridge English: First) provimi i dhënë ose BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë, ose APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).
- VËREJTJE: Nëse kandidati nuk e përbush kushtin e paraparë në pikën 1 alineja 5 të këtij konkursi në lidhje me njohjen e gjuhës angleze, ai është i obliguar që këtë kusht ta përbush në afatin prej një viti nga dita e emërimit të tij, në të kundërtën atij do të pushojë mandati (në pajtim me nenin 13 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për ndërmarrjet publike – Gazeta zyrtare e RM-së nr. 64/2018).**
- Kandidatët për drejtor, përkaj dëshmi për përbushjen e kushteve të lartpërmendura duhet të dorëzojnë edhe dokumentet vijuese:
 - fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
 - propozim programin e punës dhe zhvillimit të ndërmarrjes.
- Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët janë të detyruar që ta dorëzojnë në origjinal ose kopje të verifikuar te noter.
- Afati i parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm është 7 ditë pune nga dita e shpalljes së konkursit publik në shtypin ditor.
- Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen deri te arkivi i Qytetit të Shkupit në barakën nr. 16 – me shenjë Kryetari i Qytetit të Shkupit – Për konkursin publik për zgjedhjen e drejtorit të NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" – Shkup.
- Drejtori zgjidhet me mandatin prej 4 viteve.
- Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Qyteti i Shkupit
Kryetari i Qytetit të Shkupit
Petre Shilegov

Bul. Goce Dellçev nr. 8.
 p. f 506, 1000 Shkup
 tel. (02) 55 11 991 faks (02) 55 11 992

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2009; 130/2009; 149/2009; 50/2010; 52/2010; 124/2010; 47/2011; 11/2012; 39/2012; 13/2013; 25/2013; 170/2013; 187/2013; 113/2014; 20/2015; 33/2015; 72/2015; 129/2015 dhe 27/2016), Shoqëria aksionare për përgatitje lojërave të fatit në pronësi të shtetit, Lotaria shtetërore e Maqedonisë publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për pranimin e punëtorëve për kohë të pacaktuar

Lotaria shtetërore e Maqedonisë ka nevojë për punësim të punëtorit për kohë të pacaktuar, për vendin e punës në vijim:

- "Bashkëpunëtor i pavarur për çështje juridike" në Sektorin për çështje juridike, - 1 (një) realizues me kushtet në vijim:
 - Fakulteti juridik – shkallë të VII/1 të mbaruar ose së paku 180 kredi sipas SETK
 - Përvojë pune: së paku 3 (tre) vjet përvojë pune
 - njohje të gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj
 - njohje të MS Office aplikacioneve dhe shfrytëzimit të internetit
 - orari i javor i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte 8 (tetë) orë punë (prej ora 08 deri në ora 16)
 - pagesa bazë: 37.702,00 denarë.

Afati për paraqitje të kandidatëve është 5 (pesë) ditë pune.

Punëdhënësi do të realizojë zgjedhjen në afat prej 7 (shtatë) ditë pune pas kalimit të afatit për paraqitje të kandidatëve.

Kandidatët për vendin e lartpërmendur të punës krahas fletëparaqitjes me biografi të shkurtër duhet të dorëzojnë edhe dëshmi për përbushjen e kushteve të lartpërmendura edhe atë:

- Diplomë ose certifikatë për përgatitje të mbaruar profesionale
- Vërtetim për përvojë të punës me përgatitje të kërkuar profesionale
- Certifikatë të shtetësisë.

Dëshmitë dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i parregulluar dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët ti dorëzojnë në Shoqëria aksionare për përgatitje lojërave të fatit në pronësi të shtetit, Lotaria shtetërore e Maqedonisë, rr. Goce Dellçev nr. 8, Fahu Postal 506, 1000 Shkup.

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënësit dhe aktivitetet tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 07- 9992/2 të datës 05.06.2014, SHFK "Vasil Glavinov" – Veles, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për parashtrimin e ofertave me shkrim pa hapje publike për organizim të ekskursioneve për nxënësit e SHFK "Vasil Glavinov" – Veles (furnizim i ndarë), edhe atë:

- Ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së tretë: **Nxënësit e klasës së III** do të realizojnë ekskursion njëditor: Veles – Prilep – Krushevë – Veles

Periferitë, rajonet dhe objektet që do të vizitohen:

- Vizitë të qytetit të Prilepit – shëtitje nëpër sheshin e qytetit të Prilepit
- Vizitë të përmendores kulturo-historike "Mogilla e të pamposhturve" – Prilep
- Shëtitje nëpër qendrën e Komunës së Prilepit
- Shëtitje nëpër pyll dhe vizitë të "Meçkin Kamen" dhe "Shtëpisë përkujujmore të Toshe Proeskitt".

Ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së gjashtë: **Nxënësit e klasës së VI** do të realizojnë ekskursion dyditor: Veles-Prilep-Krushevë-Veles

Periferitë, rajonet dhe objektet që do të vizitohen:

- Prilep dita e parë – (Vizitë e Mogillës, Kullat e Markos, shëtitje individuale nëpër qendrën e qytetit)
- Krushevë dita e dytë – (Manastiri Svetlo preobrazhenie, Muzeu i Toshe Proeskitt, varri i Toshe Proeskitt, Makedonium, Shkitorja në kohën e Kyengritjes së lindenit, Galeria Nikolla Martinovski)

- Ekskursioni treditor për nxënësit e klasës së nëntë: **Nxënësit e klasës së IX** do të realizojnë ekskursion treditor: Veles-Ohër-Manastir-Veles

Qëllimet dhe detyrat:

- Pasurim i njohurive për vendet kulturo-historike nga vendi që vizitohet
- Pasurim i njohurive gjeografike nga vendi që vizitohet
- Veprimi edukativ për vetëbesimin e nxënësve

Periferitë dhe rajonet që do të vizitohen:
DITA E PARË:

- Shëtitje nëpër qytetin e Ohrit, Vizitë të shtëpisë së familjes Filev, Vizitë të shtëpisë së familjes Robev, Shikim të freskave dhe ikonave të kishës Shën Sofia, Shikim të freskave dhe ikonave të Sv. Bogorodica, Vizitë të Amfiteatrit të Ohrit, Fortesën e Samoilit, Pilaoshnik – kisha Shën Pantelajmoni, kisha Shën Jovan Kaneo, Çarshia e vjetër e Ohrit.

DITA E DYTË

- Enti hidrologjik "Biljanini izvor", Gjiri i eshrave, Manastiri Shën Naum Ohridski

DITA E TRETË

- Manastir-Shirok sokak, Heraklea

Me piknikët e njëditor do të përfshihen nxënësit e klasave I, II, IV, V, VII dhe VIII:

Nxënësit e klasës së I: Veles-Shkup-Veles

Periferitë, rajonet dhe objektet që do të vizitohen:

- Vizitë të aeroportit "Aleksandri i Madh"
- Vizitë të Muzeut shkencor-naturor
- Vizitë të Kopshtit zoologjik

Nxënësit e klasës së II: Shkolla – Parku i qytetit – shkolla

Periferitë, rajonet dhe objektet që do të vizitohen:

- Vizitë të parkut të qytetit
- Pamje të vendit, relievit dhe klimës
- Bota bimore dhe shtazore
- Vizitë të kishës Shën Kiril dhe Metodi

Nxënësit e klasës së IV: Veles-Sv. Nikole-Gjurishte-Veles

Periferitë, rajonet dhe objektet që do të vizitohen:

- Konfeksi Moda,
- Qyteti i Sv. Nikoles,
- Stacioni meteorologjik Gjurijshte,
- Vizitë të manastirit Sv. Atanasij

Nxënësit e klasës së V: Veles-Vatasha-Kavadar-Mihajllovo-Veles.

Periferitë, rajonet dhe objektet që do të vizitohen:

- Vizitë të pushimores Mihajllovo
- Përmendoret

Komisioni për grumbullimin e ofertave me shkrim

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI

www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
 tel. +389 (0) 42 213 511
 fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18 – 692/1
 30.04.2018 vit
 Gostivar

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gaz. Zyrtare e RM nr. 5/02), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

THIRRJE PUBLIKE

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik në territorin e Komunës së Gostivarit për shpalljen e **Thirrjes publike** për dorëzimin e iniciativave për përpunimin e Planeve urbanistike.

- Thirrja publike do të zgjasë prej 07.05.2018 deri 06.06.2018 vit.
- Thirrja publike do të shpallet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Gostivarit www.gostivari.gov.mk, në tabelën e shpalljeve në komunë, në sistemin informativ e-urbanizëm dhe në shtypin ditor "Maqedonia e Re" dhe "Koha".
- Secili person fizik dhe juridik i interesuar në periudhën e thirrjes publike mundet të dorëzojë iniciativën për përpunimin dhe sjelljen e planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alineja 2, 3 dhe 4 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik.
- Lëndë për iniciativë mund të jetë sjellja e Planit të ri urbanistik, ndryshimi dhe plotësimi i Planeve urbanistike ekzistuese ose Dokumentacioneve planore urbanistike.
- Personat e interesuar fizik dhe juridik iniciativat mundet t'i dorëzojnë në formë të shkruar në Qendrën për shërbime publike të Komunës së Gostivarit ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afatin e paraparë.
- Për iniciativat e dorëzuara parashtruesit do të jenë të informuar në formë të shkruar ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e – urbanizëm në afat prej 15 ditë pune nga kalimi i afatit për dorëzimin e iniciativave.
- Iniciativat e pranuar nga Thirrja publike do të inkuorohen në Programin për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës së Gostivarit për vitin 2019.

Mjetet për përpunimin e dokumentacioneve të nevojshme për iniciativat e pranuar duhet të sigurojnë personat fizik ose juridik të cilët kanë parashtruar iniciativat.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

Ismail Kadare: NJË PASDITE NË ZYRIH...



Në fletoret e mia kam shënimet për një pasdite në Zyrih. Madje, edhe titulli ashtu është "Një pasdite në Zyrih".

Ngjante me një refleks të zbehtë të një pasditeje tjetër. Në të vërtetë, kisha qenë në Zyrih dhe atë pasdite e mbaja mend mirë. Çdo ditë që mbahet mend ka një çast kur kapet kujtesa si me kanxhë. Në Zyrih ai çast ishte kur gidi që më shoqëronte, duke më treguar një shtëpi, më tha: Këtu ka jetuar Gëte. Zot, sikur ta dija, thashë me vete. Ishte e treta shtëpi që më qëllonte të shihja, që kishte lidhje me Gëten, dhe ato, jo vetëm ngjanin me njëra-tjetrën, por në fasadën e tyre kishin diçka që të kujtonin fytyrën e Gëtes, pas moshës shtatëdhjetëvjeçare. Ishte shtëpi ku mund të mendoje se kishte jetuar një shkrimtar i mesëm, por kurrsesi Gëte, gjë që të krijonte një bezdi brenda teje.

Shtëpia ndodhej në Zyrihun e vjetër, jo larg hotelit "Helmhaus", ku kisha zënë vend. Por shtetimi për Gëten do të ishte gjithsesi i paqetë, ngaqë fare pranë gjendej ndërtesa ku dadaistët gjermanë kishin shpallur artin e tyre dhe pak më tej shtëpia ku kishte banuar Lenini, për të cilën dy dadaistë të

mbetur gjallë ende, botonin kujtimet e tyre, të dy në kundërshtim me njëri-tjetrin dhe, me sa dukej, të rrejshme. (Njëri thoshte se Lenini vinte shpesh në mbrëmjet e tyre të zhurmshe për të shfaqur entuziazmin e tij për dadanë, kurse tjetri ngulte këmbë se Lenini, jo vetëm s'shkelte kurrë atje, por i mërzhitur prej zallahisë i kishte telefonuar policisë të ndërhynte për të ndërprerë orgjinë.)

Vite më pas këtu duhej të qe vërtitur Aleksandër Solzhenicini, i cili shumë herë duhej ta kishte vështruar me urrejtje tabelën gjermanisht: "Këtu ka jetuar shefi i komunistëve rusë Uljanov Lenini", ngaqë, me siguri, i qe dukur se pikërisht atje kishte nisur fatkeqësia e tij. Së fundi, si për të plotësuar tablonë, aty pranë ishte një kafene, ku Xhojsit i pëlqente të pinte verë të bardhë dhe ti, pasi e dëgjoje këtë, ishte e natyrshme që të thoshe me vete: si është e mundur që në një vend kaq të ngushtë të ishin përplasur njerëz kaq të kundërt.

Nuk e di pse, por m'u duk se për të qetësuar atë dendësi të pazakontë në tru, më tepër se largimi nga kjo hapësirë, do të ishte takimi me një shkrimtar të gjallë.

A do të shkojmë, siç më premtuat, te Max Frishi? i thashë gidit.

Ai buzëqeshi me aq djallëzi, sa ç'është në gjendje të ketë fytyra e një gidi zviceran dhe, aty për aty, tha: ne jemi ndërkaq dy hapa larg Max Frishit.

I ramë disa herë ziles së shtëpisë së Frishit dhe një fqinjë na tha se shkrimtari, me siguri, do të kishte dalë të blinte qumështin, gjë që ishte i detyruar ta bënte vetë pas ndarjes me gruan, eh, në moshën shtatëdhjetëvjeçare, për perëndi, s'ishte lehtë.

Ndërsa largoheshim, ndjeva lodhje dhe mërzë. Kisha vënë re se ndodhte shpesh të dëgjoja fjalë të hidhura, për të cilat thosha më pas: ku dreqin i dëgjoja! Ose, ku e ktheva kokën për ta parë atë shëmti. Dhe gjithmonë mendoja: si nuk isha larguar edhe pak, ose si nuk kishte erë që të mos dëgjoja, ose të ishte natë, që të mos shihja. Por ndërkaq ajo s'ndreqet më dhe ti je i detyruar të tretësh brenda teje shijen e hidhur. A nuk mjaftonte që fqinja të na thoshte se Max Frishi mungonte, dhe ç'ishte e nevojshme të na sqaronte se ndoshta kishte dalë për të blerë qumësht, dhe aq më tepër të shtonte fjalët e tjera për ndarjen nga grua? E

E ndieja se isha nervoz, herë me të tjerët, po më shumë me veten time. Ndoshta isha unë vetë që e krijoja këtë trazim. Ishte mendja ime ballkanase, së cilës i dukej ndoshta e padenjë që shkrimtari më i shquar i Zvicrës të dilte të blinte qumësht, pasi qe ndarë nga grua. E ç'dashke ti, i shfryja vetes, të rrëmbeje hanxharin, apo të ulërije për gabime ideologjike në ndonjë plenum?

Kisha vënë re se nervozohesha përherë kur dikush më prishte atë lloj magjepsjeje që mendja ime krijonte për gjërat. Ja tani po ecnim drejt hotelit "Helmhaus", emrin e të cilit, duke u nisur nga shqipja, më pëlqente ta mendoja si "Shtëpia e Helmit", dhe ndonëse e dija se s'mund të ishte ashtu, vazhdoja ta mendoja si një hotel ku

mund të të helmonin. E kisha ruajtur me aq xhelozitë atë përfytyrim, saqë, me gjithë kureshtjen, nuk e kisha pyetur asnjëherë gidin se ç'do të thoshte ky emër "Helmhaus".

Mirëpo, atë pasdite zhgënjyese, pikërisht kur unë kisha nevojë për pak riparim, për pak suvatim magjepsës mbi zhvëshjen e ftohtë, pra shi atëherë kur s'duhej, pa kurrfarë shtyese, duke hyrë në holl, gidi më tha: e dini se ç'kuptim ka emri i hotelit tuaj? Ishte aq e papritur ndërhyrja e tij, saqë nuk arrita t'i thosha "mos!", se ndërkaq shpjegimi shfarosës ishte bërë: "Helmhaus" do të thoshte gjermanisht Shtëpia e Helmit. "Ç'keni kështu? Mos nuk e ndieni veten mirë?"

Biznes me motive shqiptare

Piktura e njohur me titull "Dy rojet shqiptare para portës", që paraqet dy roje shqiptare në Egjipt, një nga kryeveprat e piktorit serb të shekullit të XIX, Paja Jovanović, është shitur në Londër. Piktura është shitur në ankandin e famshëm të artit, "Sotheby's", duke filluar nga shifra e 150 mijë stërlinave deri në shifrën përfundimtare të afro gjysmëmilionit stërlinash, duke e bërë atë pikturën më të shtrenjë të këtij piktori. Paja Jovanović ka rreth 8 tablo me tematika shqiptare dhe njihet si "orientalisti" më i madh serb. Jovanović ka udhëtuar disa herë në Shqipëri, duke qëndruar në Shkodër për t'u njohur me kostumet kombëtare shqiptare, ku thuhet se krijoi një miqësi të fortë me piktorin e shquar të

Rilindjes Kombëtare, Kol Idromenon. Ai ka qëndruar në mesin e shqiptarëve, që nga Mali i Zi e deri në Egjipt, e njihet si një ndër piktorët e rralë që ka nxjerrë me ngjyra në pëlhurë madhësinë dhe krenarinë e shqiptarit, së bashku me rrobat karakteristike. Ndër pikturat me tematikë shqiptare janë "Përgatitja e nuses shqiptare", "Mësimi i shpatës", "Vallja e shpatave", "Vajza me çifteli", "Dredhja e duhanit", "Shqiptari duke pusuar". Edhe pse nuk dihet blerësi, media serbe ka kritikuar ashpër qeverinë që nuk investon në blerjen e këtyre veprave për Muzeun e tyre Kombëtar. Ndërkohë që në Shqipëri, asnjë nga këto piktura nuk është pronë e fondit të artit, apo ndonjë koleksionisti shqiptar.



Në Sarajevë prezantohet seriali më i ri rajonal "Në konak te Hilmija"

Në Kinemanë e Sarajevës "Meeting Point" është mbajtur një konferencë për shtyp për serialin më të ri rajonal "Konak kod Hilmije" (Në konak te Hilmija), ku luan aktori kosovar Ilir Tafa. Ky serial komedi, me skenar të Feda Isovici dhe regji të Elmira Jukić, që është koproduksion i Davor Purishić dhe Nebojshe Garica, na kthen prapa në kohën e okupimit të Sarajevës gjatë luftës së Dytë Botërore, transmeton Gazeta KNN. E gjithë ngjarja zhvillohet në shtëpinë e "Hilmija", në të cilën vijon për vizitë të gjithë, duke nisur nga komunistët ilegalë, ustashat, çetnikët, ushtarët te divizionit Handzhar e deri tek ushtarët gjermanë dhe komandanti i qytetit Shtumbafirera Shillinga, ku njëri-tjetrit i bëjnë komplete para 'hundëve' dhe ku tensionet etnike bëhen më pak të rëndësishme se sa interesi material/personal.

Në këtë konferencë për shtyp morën pjesë edhe aktorët e këtij seriali: Emir Hadzhihafizbegović, Marko Cindrić, Ilir Tafa, Almir Kurt, Emir Z. Kapetanović, Adnan Omerović, Miki Trifunov dhe Dino Sarija. "Në konak te Hilmija" gjithçka është e mundur. Historia është thjesht një rrëfim, jo një detyrim i rreptë faktik. Shikuesve të këtij seriali i'u ofrohet një



lojë e shkëlqyer e aktorëve në këtë komedi. "Loja është mjaft dinamike, aktrimi i shkëlqyeshëm. Sipas tematikës dhe personazheve, "Në konak te Hilmija" shfaqet situatë e pazakontë komike, në të cilën kemi mbledhur një ekipë të mrekullueshëm të aktorëve. Presim me padurim reagimin e publikut, sepse në të flasim për historinë e vitit 1941, ndërsa po e luajmë në kohën e tashme", tha regjisori i serialit Elmira Jukić.

Seriali "Konak kod Hilmije" (Në konak te Hilmija) do të fillojë transmetimin në Bosnjë, Kroaci, Serbi dhe Mal të Zi me 7 maj ne kanal "Top".

LIGA E PARË, JAVA E 32

VAZHDON BETEJA PËR MBIJETESË DHE EVROPË

Duke marr parasysh se në kreun e tabelës është gjithçka e qartë, ku prej xhiros së 29-të Shkëndija u shpall kampion i ri, gara mes ekipeve mbetet për plasman në Evropë dhe sigurimin e mbijetesës. Njëra prej dueleve që zgjon më tepër interesim është ajo mes FC Shkupi dhe Sileksit, dy ekipe që pretendojnë Evropën



Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 1 maj - Sfidat e Ligës së parë vazhdojnë edhe në mesjavë, kur sot (e mërkurë) në pesë fushat e Maqedonisë do të zhvillohen ndeshjet e javës së 32. Duke marr parasysh se në kreun e tabelës është gjithçka e qartë, ku prej xhiros së 29-të Shkëndija u shpall kampion i ri, gara mes ekipeve mbetet për plasman në Evropë dhe sigurimin e mbijetesës. Njëra prej dueleve që zgjon më tepër interesim është ajo mes FC Shkupi dhe Sileksit, dy ekipe që pretendojnë Evropën. Ndeshja zhvillohet në Çair, ndërsa presioni më tepër bie mbi nikoqirët, duke marr parasysh se Sileksi aktualisht mban pozitën e tretë me 45 pikë tetë më shumë se bardhekaltërit, por që këta të fundit kanë një ndeshje më pak. Pas

barazimit 1-1 ndaj rivalit tjetër për të dalë në Evropë, Rabotniçkit javën e kaluar, atmosfera në radhët e "pëllumbave" është e mirë, ndërsa futbollistët presin fitore dhe përkrahjen e publikut. "Na gëzon fakti se jemi në formë të mirë të gjithë lojtarët. Në ndeshjet e fundit kemi treguar se meritojmë të jemi sa më lart në tabelë. Nuk kemi shumë kohë me menduar për ndeshjet që po i lëmë pas, shkaku se po luajmë nga dy ndeshje në javë. Tash jemi të fokusuar për Sileksin që vjen në Çair ku shpresoj përsëri stadiumi të jetë i mbushur dhe në fund të festojmë fitoren me 'Shvercerat' dhe gjithë publikun", deklaroi përfaqen e klubit Omar Imeri. Për këtë ndeshje trajneri Zekirja Ramadani po ballafaqohet me probleme, pasi nuk do të mund të

mbështetet në shërbimet e Kristian Stojkoskit, i cili ka pesë kartonë të verdhë, ndërsa në dyshim do të jetë paraqitja e Rron Brojës dhe Bllazhe Ilijoskit. Ndryshe, edhe Shkupi, por edhe Sileksi do të jenë me mendje në Tetovë, pasi Rabotniçki përballlet me Shkëndijën. Këta ta fundit pasi u shpallën kampion, i lejuan vetes të gabojnë ndaj Pobodës dhe Akademia Pandevit. Por, ndaj "romantikëve" thonë se do të jenë në nivel dhe do të arrijnë fitore para tifozëve të tyre. "Ne kemi kryer punën detyrën tonë në kampionat duke siguruar titullin dhe në kushte kur mendjen e kemi të finalja e Kupës ndodh që ekipi mos të jetë në nivelin e duhur. Këtu ndikojnë edhe arbitrat që duke ditur se pikët nuk na duhen dhe dy ndeshjet e fundit na kanë dëm-

DYSHET:

SHKËNDIJA - RABOTNIÇKI
SHKUPI - SILEKSI
VARDARI - SKOPJE
PELISTERI - RENOVA
A.PANDEV - POBEDA

tuar. Sigurisht se ne duam të vazhdojmë me fitore dhe sa më të gatshëm të presim finalen e Kupës. Besoj ndaj Rabotniçkit të jemi në nivel dhe të festojmë fitore të re para tifozëve tanë", deklaroi për KOHA, Besmir Bojku. Ndërkohë me mendje në Tetovë do të jetë edhe Renova, e cila gjithashtu synon pozitën e katërt. Kundërshtari i "gjispunuesve" do të jetë Pelisteri, skuadër kjo e cila po "lufton" për mbijetesë. Në ndeshjet tjera, Akademia Pandevi do të pret Pobodën, gjithashtu në "luftën" për mbijetesë" si dhe Vardari do të sfidohet nga "Skopje".

Muaj vendimtar për të ardhmen e Ajetit

Muaji maj do të përcaktojë përfundimisht të ardhmen e mbrojtësit të përfaqësueses shqiptare, Arlind Ajeti. Lojtari kuqezi është aktualisht i huazuar nga Torino te Krotone, por deri në fund të muajit maj do të mësojë nëse do të zgjatë qëndrimin në këtë klub, apo do të kthehet te torinezët, ku në fakt hapësirat për të mungojnë. Torino u mundua që ta shiste që në verën e kaluar, por nuk arriti të gjente blerës për lojtarin dhe në fund u detyrua ta huazonte te Krotone. Ky klub ka një opsion blerje përfundimtare të kartonit të mbrojtësit shqiptar, por sipas mediave italiane, nuk dihet ende nëse do ta aktivizojë këtë pikë të marrëveshjes me torinezët. Shkak për këtë është mungesa e qëndrueshmërisë në paraqitjet e Ajetit, i cili ka alternuar ndeshje të mira me paraqitje jo-bindëse, që e kanë kthyer shpesh në objekt kritikash nga mediat dhe tifozët e skuadrës së tij. Megjithatë, me mbijetesën e mundshme në Serinë A, Krotone i nevojiten lojtarë me eksperiencë në sezonin e ardhshëm ndaj qëndrimi i Ajetit në radhët e kësaj skuadre, qoftë edhe si alternativë në stol, duket si opsioni më i mirë i mundshëm për të dy palët.



BILARDO, U MBAJT XHIROJA E FUNDIT



Pehlivanoviç, kampion i Liga Kupës

Shkup, 1 maj - Javën e kaluar në Shkup në hapësirat e klubit "Gran Klub" është zhvilluar xhiroja e fundit, e gjashta e serisë së turnirëve të ashtuquajtura Liga e Jadranit ose Liga Kupë në Bilardo (Çaçak, Sarajevë, Podgoricë, Lubjanë dhe Shkup). Ndryshe, nikoqir i këtij turniri ka qenë "Gran Klub" që ishte edhe ko-organizator, ndërsa kanë marr pjesë një numër i madh i juniorëve, në mesin e të cilëve edhe një vajzë nga Serbia, ndërsa kanë marr pjesë edhe ish-kampion evropian, si dhe kampioni aktual deri 19-të vjeç. Derisa, fitues i turnirit deri më 19-të vjeç u shpall garuesi nga Bosnja e Hercegovina, Sanjin Pehlivanoviç.

Ndërkaq, nga "Gran Klub" u shprehën të kënaqur me organizimin e këtij turniri. "Gran Klub" si organizator dhe ko-organizator është krenar, që arriti tu përgjigjet sfidave për të qenë pjesë e një gare spektakolare, ku publiku ishte dëshmitar i lojës maestrale nga ana e të gjithë fituesve, të cilët ishin nga ish republikat jugosllave, thonë nga "Gran Klub". Ata gjithashtu uruan fituesit e medaljeve, veçanërisht fituesin Pehlivanoviç. "Urime të sinqerta për më të mirët apo fituesit e medaljeve edhe atë: Andreja Klasoviç e Aleksa Pecelj (vendi i tretë), Goran Mlladenoviç 'Grga' (vendi i dytë), ndërsa urimi i veçantë shkon për fi-

tuesin e turnirit, kampionin e botës deri 19-vjeç, Sanjin Pehlivanoviç. Gjithashtu një falënderim për të gjithë 70 pjesëmarrësit nga Serbia, Kosova, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, Kroacia dhe për garuesit e bilardot nga Maqedonia, pastaj drejtorin e turnirit Vladimir Ilievski dhe referin zyrtar të turnirit Vanja Hoxhiç dhe mikun tonë 'BilardoN'. Falënderimet shkojnë edhe për mbështetjen e ofruar nga drejtori i Agjencisë për Rini dhe Sport, Darko Kaevski, deklaruan nga klubi "Gran Klub". Në fund nga ky klub shpresojnë se janë treguar nikoqir të mirë me shpresë se do të shihen edhe në turnirët e ardhshme. (B.K.)

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15-tekst i pastruar) nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 11/18) dhe Pëligjimit nr. 18-2384/2 të datës 22.02.2018, nga Ministria e financave dhe nenit 12, nenit 16 paragrafi 1 dhe 2, e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Rada Poceva" – Kavadar, U.D Drejtori i Institutit publikon

**SHPLLJE PUBLIKE
PËR PUNËSIM PËR KOHË TË PACAKTUAR TË PUNËS**

- Dy (2) persona për vendin e punës edukator të fëmijëve të moshës prej mbi dy vjet deri në gjashtë vjet – ofruar i shërbimeve të nivelit të parë V për kohë të pacaktuar të punës
- Dy (2) persona për vendin e punës përkëdhelës – ofruar i shërbimeve nga niveli i parë G për kohë të pacaktuar të punës,
- Një (1) person për vendin e punës pedagog – ofruar i shërbimeve të nivelit të parë A për kohë të pacaktuar të punës,
- Një (1) person për vendin e punës logoped – ofruar i shërbimeve të nivelit të parë A për kohë të pacaktuar të punës,
- Një (1) person për vendin e punës mirëmbajtës i higjienës - person ndihmës-teknik për mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve të nivelit të parë A – për kohë të pacaktuar të punës.

Krahas kushteve të përgjithshme për punësim në institucion për fëmijë të parapara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Tekst i konsoliduar dhjetor 2017),

Kushtet e përgjithshme që vlejnë për të gjithë kandidatët:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik,
- Të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Të mos i jetë shqiptuar dënim me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor që dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim me person të mitur dhe abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është pacaktuar sjellje diskriminuese

Kandidatët për vendin e punës edukator të fëmijëve të moshës prej mbi dy vjet deri në gjashtë vjet duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- PSP - Profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar të fëmijëve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar shkalla e VIII/1 ose arsim të mbaruar përkatës sipëror për edukator arsimi (Pedagogji)
 - Licencë valide për bashkëpunëtor profesional
 - Me ose pa përvojë pune,
- Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të pacaktuar
Orari ditor i punës është prej ora 07:30-15.30 prej të cilave 6 orë punë me fëmijë dhe pjesa tjetër e orarit të punës parashihet për aktivitete tjera dhe përgatitje
Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 19.100,00 denarë

Kandidatët për vendin e punës përkëdhelës duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar,
 - licencë valide për përkëdhelës,
 - me dhe pa përvojë pune,
- Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të pacaktuar.
Orari ditor i punës është prej ora 08:00-16.00 dhe prej ora 10:00-18:00 prej të cilave 7 orë punë me fëmijë, dhe pjesa tjetër e orarit të punës parashihet për aktivitete tjera dhe përgatitje
Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 14.000,00 denarë

Kandidatët për vendin e punës pedagog në cerdhe për fëmijë duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- PSP të mbaruar me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VIII/1 – fakulteti filozofik – arsimi (pedagogji),
 - licencë valide për bashkëpunëtor profesional,
 - me dhe pa përvojë pune,
- Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të pacaktuar.
Orari ditor i punës është prej ora 07:30-15.30 prej të cilave 5 orë punë me fëmijë dhe pjesa tjetër e orarit të punës parashihet për aktivitete tjera dhe përgatitje.
Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 19.100,00 denarë

Kandidatët për vendin e punës logoped në cerdhe për fëmijë duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- PSP të mbaruar me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VIII/1 – fakulteti filozofik – arsimi (logopedi)
 - licencë valide për punëtor profesional,
 - me dhe pa përvojë pune,
- Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të pacaktuar.
Orari ditor i punës është prej ora 07:30-15.30 prej të cilave 5 orë punë me fëmijë dhe pjesa tjetër e orarit të punës parashihet për aktivitete tjera dhe përgatitje.
Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 19.100,00 denarë

Kandidatët për vendin e punës mirëmbajtës të higjienës duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- arsim fillor ose të mesëm të mbaruar katërvjeçar,
 - me dhe pa përvojë pune,
- Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të pacaktuar.
Orari ditor i punës është prej ora 06:00-14:00.
Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 12.000,00 denarë
Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Dokumentet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, dhe të njëjtat të mos jenë më të vjetra se gjashtë muaj. Dokumentet që arrijnë të paplotësuar nuk do të merren parasysh.
Kandidatët e interesuar për marrje të më shumë informata mund të drejtohen në numrin e telefonit 043/412-097, ndërsa aplikacionet e tyre mund të parashtrijnë në arkivin e IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar, rr. "Braqa Xhunovi" nr. 11a (qerthija qendrore).

IPKÇF "Rada Poceva"
U. D Drejtor,
Cana Dobrinova

Në bazë të nenit 132 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 15/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 dhe 135/14) dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Novacit, Këshilli i shkollës së SHKF "Slavko Ljubarkovski" – Novaci më datë 02.05.2018 publikon

**SHPLLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të Drejtorit të shkollës**

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara në LMP kandidatët duhet të përmbushin kushtet për mësimdhënës, bashkëpunëtor profesional në shkollë në pajtim me LAF:

- Të ketë së paku arsim sipëror dhe të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore,
- Të ketë pesë vjet përvojë pune në punë edukativo arsimore,
- Të ketë të dhënë provimin për drejtor,
- Të jetë shtetas i R. Maqedonisë,
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik

Kandidatët për drejtor të shkollës krahas lutjeve dhe biografisë së shkurtë – CV duhet të parashtrijnë dokumentet në vijim:

- Diplomë për arsim të mbaruar sipëror,
- Vërtetim për përvojën e punës në punë edukativo-arsimore,
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të shkollës fillore.
- Certifikatë të shtetësisë së R. Maqedonisë
- Deklaratë (kryesisht në formularin nr. 1) në pajtim me nenin 6 pika 1 dhe pika 4 e Ligjit për përcaktim të kushtit plotësues për kryerje të funksionit publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 14/08 dhe 64/09) të vërtetuar në noter.
- Vërtetim për evidencë ndëshkimore – jo më të vjetër se 6 muaj.
- Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrijnë program për punë për periudhën prej 4 vjet.

*Orari i punës prej ora 07:30 deri në ora 15:30 prej ditës së hënë deri ditën premte (40 orë pune në javë)

*Pagesa fillestare 26.000,00 den.

Shpallja zgjatë 8 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.
Zgjedhja e drejtorit do të realizohet në pajtim me LMP brenda afatit të caktuar me ligji.
Dokumentet parashtrihen personalisht ose përmes postës deri te Këshilli i shkollës.

Tel. 047 282-446

Zëvendës kryetar i KSH
/Aneta Soklevska /

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1 alineja 7 të Ligjit për Arsim Profesional dhe Trajnim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/06, 117/08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 41/14, 145/15 dhe 55/16) dhe nenit 16 të Statutit të Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim - Shkup, Këshilli Drejtues i Qendrës për Arsimin Profesional dhe Trajnim, shpall:

**SHPLLJE PUBLIKE
për emërimin e zëvendës drejtorit të Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim**

Kandidati duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e emërimit nuk i është shqiptuar dënim ose kundërvajtje për kryerjen e një profesioni, veprimtarie ose detyre;
- të ketë së paku 240 kredi sipas ECTS ose të ketë përfunduar shkallën VIII/1;
- të jetë mësimdhënës me së paku pesë vjet përvojë pune në arsimin profesional ose të jetë i punësuar së paku pesë vjet në një organ administrativ kompetent për çështjet e arsimit ose decentralizimit;
- të ketë një nga certifikatat ose vërtetimet e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFL iBT së paku 74 pikë,
 - IELTS së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) e dhënë,
 - BULATS së paku 60 pikë, ose
 - APTIS së paku niveli B2, dhe
- të ketë dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Të gjithë aplikantët që do të aplikojnë, vërtetimet e nevojshme dhe dokumentet e tjera me të cilat e vërtetojnë përmbushjen e kushteve të lartpërmendura, në origjinal ose fotokopje të vërtetuara nga noter, së bashku me letërën shoqëruese: një biografi të shkurtër, duhet t'i dorëzojnë në arkivin e Qendrës ose me postë në adresën: Bul. Goce Delcev Nr.18 Shkup p.fax 290, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim, e detyrueshme me një shënim: „për shpallje publike” dhe „mos hap”.

Dokumentet (vërtetimet / certifikatat) që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të pikës 1 dhe 2 nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj.

Shpallja publike zgjat tetë (8) ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Nuk do të shqyrtohen fletëparaqitjet që do të jenë të pakompletuara dhe të cilat nuk do të shënohen në mënyrë të duhur dhe të dorëzuara në kohë.

Kandidatët që plotësojnë kushtet nga shpallja do të thirren për një intervistë brenda një periudhe prej pesë ditësh pas mbylljes së shpalljes.

Kandidatët të cilët nuk do të përzgjidhen do të njoftohen me shkrim për përzgjedhjen.

**Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim
Kryetari i Këshillit Drejtues**

Në bazë të Vendimit të Kryetarit të komunës së Kërçovës me nr. 09-1120/1 të dt. 25.04.2018 dhe në bazë të nenit 132 dhe 135 paragrafi 4, të Ligjit për arsim fillor (Gaz.zyrt. RM. nr. 103/2008),Këshilli Drejtues pranë SHF"Gj.K.Skënderbeu" fsh.Sërbicë-Kërçovë publikon:

**SHPLLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të shkollës**

Për drejtor të shkollës fillore mund të zgjidhet person i cili krahas kushteve të përgjithshme të parapara në LMP,duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

- Të kenë të kryer arsimin profesional superior (për arsimtar,pedagog ose psikolog),
 - Të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucionet edukativo-arsimore të verifikuara nga MASH,
 - Të kenë të dhënë provimin për drejtor,
 - Të jenë shtetas të RM,
 - Të jenë psikikisht dhe fizikisht i shëndosh,
 - Të mos të jenë të dënuar për Vepra Penale dhe të mos ketë të ngritur kundër tyre procedurë penale.
- Kandidatët nëse është e nevojshme duhet të dorëzojnë dhe dokumente shtesë edhe atë sipas vlerësimit të komisionit shkollor.

Kandidatët e interesuar kërkesës duhet bashkangjitur:

-Diplomën për arsim përkatës

Afati i shpalljes do të jetë i hapur 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

Dokumentacioni dorëzohet në SHF"Gj.K.Skënderbeu" fsh. Sërbicë-Kërçovë.

Nga Këshilli Drejtues i SHF"Gj.K. Skënderbeu"
fsh.Sërbicë - Kërçovë

IPSH Spitali Klinik Tetovë, shpallë Vulën rrethore dy gjuhësore si të pavlefshme me përmbajtjen në vijim:

1 IPSH Spitali Klinik Tetovë – Nj.O. Sëmundje kirurgjike
3x3 cm

Në mes stema dhe 1
IPSH Spitali klinik Tetovë
Drejtori
Doc. Dr. Florin Besimi

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Koha <http://www.koha.mk>

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delcev nr.11, I Q.T. Mavrovazja lok.14 - përdhësë, Shkup

MANÇINI DREJT STOLIT TË ITALISË, PRITET VETËM ZYRTARIZIMI



Roberto Mançini dhe Italia: një martesë e destinuar të materializohet. Të hënën, në fshehtësi, por jo shumë, trajneri 53-vjeçar u takua me drejtuesit e FIGC në Romë, duke u dhënë atyre mundësinë e plotë. I pranishëm në takim ishte menaxheri i ekipit blu, Lele Orioli, dhe zv.presidenti i FIGC, Alessandro Kostakurta. Një bisedë e parë e drejtpërdrejtë, në përpjekje për të eksploruar situatën, por që së shpejti duhet të çojë në "tym të bardhë". Mançini, aspak i kënaqur me detyrën aktuale si trajner i Zenit të Shën Petersburg, ka fituar kështu pozitën absolute në "pole". Kjo edhe për shkak se, pasi nuk ra dakord me Karlo Ançelotti, FIGC e gjen veten të detyruar të përshpejtojë procedurat. Dhe, saktësisht, Mançini përfaqëson një zgjedhje të shpejtë dhe produktive.

Mançini, aspak i kënaqur me detyrën aktuale si trajneri i Zenit të Shën Petersburg, ka fituar kështu pozitën absolute në "pole". Kjo edhe për shkak se, pasi nuk ra dakord me Karlo Ançelotti, FIGC e gjen veten të detyruar të përshpejtojë procedurat. Dhe, saktësisht, Mançini përfaqëson një zgjedhje të shpejtë dhe produktive.

neri i Interit është duke u përgatitur për të kuroreuzuar një ëndërr të vjetër dhe të dashur. Në fakt, drejtimi i ekipit kombëtar ka qenë gjithmonë qëllimi i "Mancio". Një faktor tjetër që i ka shtyrë drejtuesit federalë të përshpejtojnë. "Për një trajner, stërvitja e Italisë, njërit prej ekipeve kombëtare më të rëndësishme në botë, është detyrë prestigjioze, për t'u krenuar, — përsëriti Mançini në "Radio Rai", përpara se të lëshohej një shaka që tregon besimin e tij për të qenë në gjendje të ngrejë ekipin kombëtar axurr. — Pasiguria në menaxhimin e lartë? Me një federatë të porositur kemi fituar Kupën e Botës në vitin 2006. Ndoshta kjo është një shenjë e mirë..." Marrëveshja midis palëve është tani një hap larg. Posti i lënë bosh nga Ventura është gati për të mësuar pasardhësin.

Konte dhe Sarri ndërrojnë pozicionet

Maurizio Sarri do të jetë trajneri i ri i Çellsit ndërsa Antonio Conte do të jetë trajneri i ri i Napolit. Ka qenë ky lajmi i bujshëm që mediat britanike bëjnë me dije, duke konfirmuar se dy trajnerët italianë do të shkëmbejnë pozicionet e tyre në fund të këtij sezoni. "Mirror" madje e konfirmon këtë transferim, duke deklaruar se presidenti i Çellsit, Roman Abramoviç ka arritur marrëveshjen me trajnerin Sarri, ndërkohë që edhe presidenti napoletan Aurelio De Laurentis e pëlqen shumë trajnerin Conte. Një shkëmbin që do t'i surprizojë të gjithë edhe pse u bë pak kohë që përflitet se të dy këta trajnerë nuk janë të konfirmuar në skuadrat aktuale për sezonin e ardhshëm. Duket se Sarri është i interesuar për të provuar një përvojë në Pre-



mier Ligë, për të ndërtuar sërish një Çellsit të madh. ndërsa, në anën tjetër, Conte do të përpiqet që të bëjë me Napolin atë që

pat bërë edhe me Juventusin disa sezona më parë, për ta nxjerrë kampion në Serinë A. Ndaj ky shkëmbim po çmend mediat.

Venger synon stolin e përfaqësueses franceze

Arsene Wenger i tha lamtumirë skuadrës së Arsenalit pas 22 vitësh drejtim, ndërkohë që zërat se trajneri francez do të rikthehet në vendlindjen e tij janë të shumtë. Ditët e fundit u përfol se trajneri 68-vjeçar do të jetë trajneri i ardhshëm i skuadrës së Paris Sen Zhermen, por duket se Wenger ka të tjera plane. E përditshmja britanike "Daily Star" bën me dije sot se objektivi sekret i trajnerit Arsen Wenger është të drejtojë kombëtaren franceze. Për të bërë realitet këtë gjë, trajneri është gati të refuzojë edhe një ofertë ëndërrash që i bën PSZH-ja. Kombëtarja e

"gjelave" aktualisht drejtohet nga Didier Deshamps, e kualifikuar për në Botërorin e Rusi 2018, ku synon të bëjë një paraqitje të mirë. Franca ka një ekip me shumë yje, por që me kombëtaren nuk po arrijnë të fitojnë, ndaj Wenger beson se mund t'i bëjë këta yje të fitojnë një Evropian apo Botëror. Gjithçka për sa i përket kalimit të trajnerit 68-vjeçar te stoli i "gjelave" do të varet nga paraqitja që Franca do të bëjë në botëror, nëse do të arrijë të shkojë larg apo jo. Wenger është në pritje dhe nuk pritët të firmosë kontratë deri në korrik.



LAJME SHKURT

Kavani ia mbyll derën Juves

Edhe pse është përfolur shumë për një rikthim në Itali, por këtë herë me fanellën e Juventusit, Edinson Kavani nuk ka aspak ndërmend të largohet nga Paris SZH gjatë kësaj merkatoje vere. 31-vjeçari, gjatë një interviste, deklaroi se pavarësisht se e ardhmja e një lojtari nuk varet vetëm nga dëshira e tij, por edhe nga klubi, gjithsesi nuk ka aspak ndërmend të largohet. Uru-guaiani u shpreh se të parisienët ndihet i lumtur dhe se shpreson të vazhdojë të fitojë me këtë skuadër. Gjatë këtij sezoni Kavani, ka shënuar 38 gola dhe ka dhënë 12 asistime në 46 ndeshje të luajtura.

Çellsit e Atletiko në gjurmët e yllit të Sportingut

E ardhmja e Bruno Fernandes me fanellën e Sportingut është në dyshim, pasi lojtari pëlqehet nga skuadra të mëdha. Sipas mediave portugeze, në "pole position" për shërbimet e 23-vjeçarit janë Atletiko Madrid dhe Çellsit. Po sipas asaj që raportojnë mediat, "Blutë e Londrës" janë në avantazh ndaj spanjollëve, pasi kanë nisur kontaktet me agjentët e futbollistit, i cili pëlqehet shumë edhe nga Juventusit. Gjithsesi për mesfushorin parashikohet një merkato e nxehtë pasi skuadrat e interesuara për të, do të bëjnë maksimumin për ta rrëmbyer. Moshë dhe çmimi i kartonit e bëjnë akoma më të vlerësuar Fernandesin.

Nuk kam moshë për eksperiencën të reja

Ragja Nainggolan largon zërat e merkatos dhe qetëson tifozët e Romës lidhur me të ardhmen e tij. 29-vjeçari e bëri edhe një herë të qartë se dëshira e tij është të qëndrojë te verdhekuqtë dhe se është shumë i përqendruar për të dhënë maksimumin për ekipin e tij. Belgu sqaroi se vitin e shkuar kishte pasur kontakte me Çellsin, por gjithçka ishte mbyllur aty, pasi zgjedhja e tij e parë mbetej Roma. Ai pohoi se futbollit anglez i pëlqen shumë, por është shumë pranë të 30-tave dhe rifillimi nga zero nuk bën për të.

Alberto nuk dëshiron të largohet

Fantazisti spanjoll i Lacios, Luis Alberto ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve me paraqitjet e tij spektakolare, mes të cilave edhe Barcelona, që po kërkon me ngulm ta rikthejë në Spanjë. Gjithsesi ai ka deklaruar se ndihet mjaft mirë te klubi bardhekaltër, duke shprehur dëshirën për të mbetur të paktën edhe një sezon pjesë e Lacios. "Unë dhe familja ime jemi përshtatur mjaft mirë në Romë dhe jetojmë mirë. Nëse nuk ndodh ndonjë gjë e paparashikueshme, atëherë do të dëshiroja të mbetesh pjesë e Lacios për të paktën edhe një sezon tjetër. Gjithsesi, tani kemi verën përpara dhe do të jenë drejtuesit e klubit, ata që do të vendosin çfarë është më mirë për të dy palët", deklaroi Luis Alberto.

Te Roma nuk dorëzohen, derisa lojtarët nuk e fshehin besimin në lidhje me mundësinë që ekipi i tyre të përmbysë disavantazhin e rëndë 5-2 nga ndeshja e parë

Pritja për gjysmëfinalen e kthimit të Ligës së Kampionëve mes Romës dhe Liverpulit mori fund. Ndeshja kthyesë zhvillohet sonte (e mërkurë) në "Olimpico", aty ku më 10 prill ndodhi mrekullia, kur Roma përmbysi negativën me Barcelonën nga ndeshja e parë prej 4-1 dhe po në këtë stadium arriti fitore me 3-0 dhe në fund të plasohet në gjysmëfinale. Derisa, tani kundër Liverpulit është ndryshe, pasi skuadra romake do të tentojë të përmbysë negativën nga ndeshja e parë kur u mund me disavantazhin e thellë 5-2. Te Roma nuk dorëzohen, derisa lojtarët nuk e fshehin besimin në lidhje me mundësinë që ekipi i tyre të përmbysë disavantazhin e rëndë 5-2 nga ndeshja e parë. Ndërkaq, besimin për një përmbysje eventuale nuk e fsheh edhe portieri i Romës, Alisson Beker. "Ne e dimë forcën tonë të vërtetë", - tha braziliani. "E dimë se nuk është publiku, si lojtar i dymbëdhjetë, që në shtëpi nuk ka munguar kurrë, ai që mundi 3-0 Çellsin dhe Barcelonën. Natyrisht, mbështetja e madhe e tifozëve na jep siguri, ndaj mendoj se kemi 50 për qind shans për ta kaluar raundin", shtoi më tej numri një i Romës. Alisson ndien rrezik përsëri, sepse do të ketë përballë një ish, Mohamed Salah. "Është e vështirë, - ka pranuar Alisson. - Ai ka talent të natyreshëm dhe tani ka një vetëbesim të ja-

LIGA E KAMPIONËVE, NË "OLIMPICO" ROMA PRET LIVERPULIN



ROMAKËT BESOJNË TE PËRMBYSJA

shtëzakonshëm, por ne mund ta ndalojmë duke luajtur si ekip. Mes-si është lojtari më i mirë, ndaj të cilit kam luajtur, por tani nga 'Momo' duhet të kemi frikë si nga argjentinasi", deklaroi Alisson. Derisa, për sfidën e sotme ka folur edhe Stefan El Shaaravy. "Do të na duhet një tjetër arritje si ajo kundër Barcelonës dhe kemi treguar se mund t'ia dalim. Duhet të gabojmë sa më pak, sepse Liverpuli të ndëshkon, por edhe Barcelona njëlloj ishte. Nuk e di nëse do të jem titullar, moduli nuk ka shumë rëndësi, por përkushtimi i futbollistëve. Salah ka pasur një shpërthim të jashtëzakonshëm sivjet. Jam i lumtur për të sepse është një djalë i artë dhe kujdeset

"KRAHU I DJATHTË" I KLOPPIT LARGOHET NGA LIVERPULI

Përgatitjet e Liverpulit për ndeshjen e kthimit të "Champions League" ndaj Romës u tronditë nga largimi i papritur i asistentit të Jurgen Klopp. Zhelko Buvaç është larguar nga klubi për arsye personale në prag të ndeshjes më të madhe të sezonit. Serbo-boshnjaku ka qenë dora e djathtë e Kloppit për 17 vite, dyshja ka luajtur së bashku te Mainci, por ai ka vendosur të largohet për një kohë të pacaktuar nga klubi. Dyshja është



njohur te Mainz, ku Klopp luajti për 11 vite. Buvaç ishte një mesfushor ofensivë dhe ka luajtur për tre vite përkrah Kloppit. Ata i kishin premtuar njëri-tjetrit se kushdo që do t'ia dilte të bëhej trajner i pari do të tërhiqte tjetrin. Kur Klopp u kthye në lojtar/trajner te Mainci, ai iu bashkua dhe dyshja nuk është ndarë më që prej atij momenti. Ata kanë qenë së bashku te Borussia Dortmundi, dhe tani te Liverpuli.

për çdo detaj. Punon shumë dhe e meriton", deklaroi El Shaaravy. Në anën tjetër, ka folur edhe trajneri i Liverpulit, Jurgen Klopp. "Ne krijuam një bazë dhe tani duhet të mbarojmë. Ka disa gjëra për të bërë. Le të luajmë ndeshjen e ardh-

shme, të përpiqemi të bëjmë më të mirën, atëherë do të shohim", deklaroi Klopp. Ndryshe, Klopp në "Olimpico" do të jetë pa katër lojtar, Aleks Oklade Çembërlejn, i cili pësoi një lëndim në ndeshjen e parë, pastaj Adam Lallana, Emre Khan

dhe Joel Matip. Në anën tjetër, trajneri i Romës, Di Francesco nuk do të mund të llogaritet në shërbimet e Diego Peroti, i cili ka të lënduar kyçin e këmbës, ndërsa në dyshim është Kevin Strotman.

Shalke përjashton talentin e skuadrës



Shalke 04 pezullon Maks Mejer. Shkak është bërë një intervistë e mesfushorit 22-vjeçar, dhënë për "BILD", ku futbollisti gjerman dilte kundër drejtuesve të klubit dhe trajnerit Domenico Tedesko. Lajmin për pezullimin e lojtarit e ka dhënë vetë klubi gjerman, ditën e hënë. "Nuk mund të

tolerojmë të tilla fjalë dhe akuza nga lojtarët tanë. Për më tepër që janë akuza të gabuara. Shalke 04 ka mbajtur gjithmonë një qëndrim korrekt ndaj Maks Mejer", deklaroi drejtori Sportiv, Kristian Heidel. Kontrata e Mejer me Shalke 04 përfundon në fund të këtij sezoni dhe ai kishte refuzuar rinovimin e saj. Tashmë ai nuk do të marrë pjesë në asnjë seancë stërvitore të klubit dhe nuk do të grumbullohet në asnjë ndeshje të mbetur në Bundesligë. Mejer kishte kritikuar Drejtorin Sportiv, Heidel, trajnerin Domenico Tedesko dhe kreun e Bordit Drejtues, Klemens Tonnies. "Nuk dua të qëndroj te Shalke dhe të punoj me Heidel. Është e thjeshtë. Është mendjemadh", kishte deklaruar Mejer për "BILD".

MAURICIO POKETTINO JEP GARANCI

Kin, në top-formë për Botërorin e Rosisë

Harry Kin do të jetë gati të shkëlqejë me Anglinë në Kupën e Botës, këtë verë, - thotë trajneri i Totenhemit, Mauricio Pochettino. Kin, 24 vjeç, ishte në shënjestër, pasi "Spurs" i kanë rritur gjasat e tyre për një vend në "top 4" e Premier Ligw tekta vijuan me një fitore 2-0 ndaj Watford, të hënë. Ylli i Anglisë po pritët me shumë interes nga Garet Sautgejt, ndërsa afrohet Kampionati Botëror. Dhe Pokettino po e mbështet Kin, i cili kohët e fundit u kthye nga një dëmtim i kyçit të këmbës. Trajneri argjentinasi i "Spurs" mendon se Kin do të arrijë në turnirin e Rosisë në kushte të shkëlqyera fizike, ndërsa pret që Anglia të bëjë përshtypje të mira në këtë Botëror. Kur u pyet për Kin, pas fitores ndaj Watford, Pochettino tha: "Ai ka nevojë për t'i përmirësuar shfaqjet e tij, por ne



jemi ende të lumtur. Është një përzierje e gjërave të ndryshme. Nuk ishte një periudhë e mrekulueshme për të në javët e fundit, por me ndihmën e të gjithëve, po bën mirë. Ai është një djalë i fortë, fizikisht dhe mentalisht. Jam i sigurt se do të luajë për ne dhe pa dyshim do të arrijë në gjendje shumë të mirë për Kupën e Botës".

Kin ka shënuar tre gola në katër ndeshjet e fundit të Premier Ligë, që kur u kthye nga problemi i kyçit të këmbës, dëmtim të cilin e pësoi kundër Burnmaut, në mars. Futbollisti anglez është aktualisht në kuotën e 27 golave për këtë sezon, 4 gola pas Mohamed Salah të Liverpulit, në garën për "Këpucën e Artë".

DASHI 21. mars - 20. prill

Kjo dite nuk do jete shume e thjeshte për t'u jetuar nga ata qe janë ne një lidhje. Partneri nuk do jete shume i gatshëm t'ua plotësojë dëshirat dhe kjo do iu zemërojë pa mase. As debatet nuk do mungojnë. Beqaret nuk do tregohen te hapur dhe për këtë arsye do humbin disa mundësi shume te mira për takime. Financat do jene me te organizuara dhe nuk priten probleme.

DEMI 21. prill - 21. maj

Konfigurimi i yjeve do jete shume i mire gjate kësaj dite dhe jeta juaj ne çift do ketë ndryshime rrënjësore. Do qëndroni gjithë kohës me këmbë ne toke dhe do ia plotësoni disa dëshira partnerit. Për beqaret priten disa takime, por vetëm kaq. Financat duhen menaxhuar me inteligjence dhe maturi. Nëse e bëni këtë do keni përmirësime goxha te ndjeshme.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Dite shume e qete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do flisni hapur me partnerin dhe me mirëkuptim do i zgjidhni disa pengje te mbetura prej kohesh. Beqaret do e kenë shume te vështirë te krijojnë një lidhje sepse nuk do ua mbushin shume mendjen personat qe do takojnë. Për financat do jete dite mjaft pozitive kështu qe mund te kryeni edhe ndonjë shpenzime me tepër.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Kujdes me kokëfortësinë gjate kësaj dite sepse është shume e thjeshte te shkatërrosh një lidhje te hershme, por tepër e vështirë për ta ringritur atë. Beqaret nuk do kenë ndryshime ne jetën sentimentale, megjithatë nuk do ndihen keq edhe ashtu si janë. Ndikimi i Merkurit ne planin financiar do jete pozitiv dhe harmonik. Kryeni investimet e menduara prej kohesh.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Hëna do jete planeti me i favorshëm për dashurinë sot. Do jeni e dy objektive dhe do bëni atë qe është me mire për te dyja palët. Po vazhduat ne këtë rruge shume shpejt do keni ndryshime rrënjësore. Beqaret duhet t'i japin me tepër prioritet jetës sentimentale dhe jo ta lënë pas dore atë. Ne plani financiar nuk duhet ne asnjë mënyrë te rrezikoni me shume sesa duhet.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Do keni një dëshirë te papërmbajtshme sot për t'u ndier te dëshiruar dhe kjo mund t'i u çojë ne rruge te gabuar. Mos bëni gabimin ta tradhtoni partnerin nëse ai nuk ua plotëson dot dëshirat. Beqaret do afrohen shume me një person qe kane kohe qe e pëlqejnë. Financat do kenë disa tronditje për shkak se do kryeni me shume shpenzime sesa ua mban xhepi.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Klima ne çift do filloje qe sot te ngrohet dalëngadalë. Do jeni me tolerante me partnerin dhe do pranoni te bashkëpunoni me te. Edhe ai do tregohet i gatshëm t'ua beje qejfin ne çdo moment. Beqaret nuk do ndihen ende gati për te filluar një lidhje edhe pse mundësitë do jene te mira. Financat do jene ne gjendje shume te mire nëse vazhdoni te shpenzoni me maturi.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Priten një përmirësim i ndjeshëm sot ne jetën tuaj ne çift. Do i analizoni mire gjerat para se te veproni dhe nuk do krijohet asnjë hatërmbetje. Beqaret do iu kushtojnë me tepër rëndësi miqve te cilët i kane lënë pas dore dhe nuk do kenë kohe te kërkojnë dashurinë. Dijeni se koha ikën shume shpejt. Fale ndihmës se Diellit ne planin financiar situata do stabilizohet.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Jeni ne një lidhje prej shume kohesh? Sot pritet te rikthehen emocionet e fillimit te lidhjes dhe gjithçka do shkoje për mrekulli. Nuk do iu ike për asnjë moment buzëqeshja nga fytyra. Beqaret do e gjejnë princin e tyre te kaltër dhe do mendojnë menjëherë te krijojnë një lidhje me te. Ne planin financiar mos u alarmoni me problemin e para qe do iu dale para.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Nëse keni kaluar një periudhe te vështirë për jetën tuaj ne çift, me ne fund do rivendosni paqen dhe do ndiheni me te qete se kurrë. Tregohuni sa me realiste dhe arsyetoni me maturi. Beqaret do dëshirojnë shume te krijojnë një lidhje, por nga ana tjetër një angazhim serioz do i stepe. Financat nuk do jene ne gjendjen me te mire. Shmangni shpenzimet, por edhe huate.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Dielli dhe Marsi do jene planetët qe do ndikojnë ne jetën tuaj ne çift dhe do e bëjnë atë me te bukur se me pare. Edhe ju do jepni shume nga vetja juaj qe marrëdhënia me partnerin te jete sa me emocionuese. Dashuritë me shikim te pare nuk do mungojnë për beqaret, prandaj ata duhet te përfitojnë sa te mundnin. Një menaxhim i mire i financave do e përmirësonte shpejt buxhetin.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do e joshni gjate gjithë kohës partnerin tuaj sot dhe marrëdhënia ne çift do jete mjaft e ngrohte. Ne mbrëmje mendoni për një darke romantike, me qirin dhe me ndonjë gatim te shijshëm. Beqaret do jene te pavendosur për atë qe duan ne te vërtetë dhe nuk do e kërkojnë dashurinë. Buxheti do jete goxha i qëndrueshëm dhe kjo do iu qetësojë.



4 vjet pa më të dashurin tonë Kaluan dy muaj pa të dashurin tonë të paharruar

AVNI TAHIRI
09.06.1992-30.04.2015

Po kalojnë muajt, po kalojnë edhe vitet, por lotët tonë akoma nuk janë larguar. Na ka marrë malli o vëlla të të përqafojmë. Na ka marrë malli zërin të ta dëgjojmë. Na mungon shumë, por askujt nuk i tregojmë. Këto fjalë ti na thojë, ne me lot të kujtojmë. Na bërë shumë dhurata, na le shumë kujtime. Por dhurata më e bukur ishte kur ta dëgjonim zërin tek po flisje. Përse jeta është kaq e vështirë. Përse jeta duhet të marr njerëzit më të mirë. Përse duhet ti marrë djalin e vogël një nëne. Përse duhet ti marr vëllan dy motrave. Përse Avnia jonë nuk është këtu me ne. Përse! Kjo është fjala që na i copëton zemrat.

E përkujtojmë: Babai Huzriu, nëna Hajria, vëllezërit Jahia me të shoqen dhe Elvira e vogël, Mahiri me të shoqen, fëmijët Florimi, Festimi dhe Fatimja. Motrat Myqeremja, Hyrijeti me të shoqin, fëmijët Venharin dhe Metinin, nga fshati Kapazhdoll.

ME DATËN 30 04 2012 NDERROI JETË



Zonja Fete Ibraimi

Gjithnjë të kemi në shpirt dhe të kujtojmë me mall. Vajza Hana dhe mbesa Donika, djali Urimi dhe bashkëshorti Numani. Zoti e bekoftë dhe të shpërbleftë me Parajsë

Mensur Mamuti	Mbledhje e Gjere e Anëtarëve të Një Partie Kryeqyteti i Azerbejxhanit	F	Lloj Guri të Çmuar Kadë Druri, Tinari	S	Emri i Vjetër i Tokios	Pjesë e Der	Elektro Motor	Vepër e Autorit në Foto	P	Degë e Vecantë e Një Institucioni (Sh.)
REVISTA NË TË CILEN PUNOI AUTORI NË FOTO								Ë. F. GAZETARIA DHE AUTORJA ITALIANA, FALAÇI		
HKRIMTARI DHE GAZETARI KOSOVAR NË FOTO										
KURESHTAR BIXHOZ							CILINDER RRROTULLUES I NËJ MEKANIZMI BANORËT E QYTET. TË AUT. NË FOTO			
K					PËRKULJA, EPJA					
								LUMË NË POLONI PËRFUNDIMTAR		
								F		
								VEGËL BUJQËSORE (SH. PASHQ.)		
							TEMPERATURA	EDMOND TUPJA QYTEZË NË GJERMANI		
							NGJYRË (ANG.)			AKTORJA AMERIKANE, UEST
							VEND BREGDETAR BOSHNIAK			
							NË ATË VEND			
KOHA	QYTET NË IRAN	FUTBOLLISTI BRAZILIAN, KRISTIAN ÇAGAS TARUKO	MARKË GJERMANE AUTOMOBILASH	KËNGËTARJA JONË, KAÇKA	KOHA	PJESË E LOJËS SË TENISIT MIKU, JARANI				STOMAK (BISED.)
ISHULL KORAL					NGUROSJE, PLAGOSJE E RËNDË FILIZ, PINJOLL					
KALI INILIT										
QË KA VETI TË ETERTIT							GRUPI ANGLEZ, XEPELIN TEMPO			
VENDI I IMAGJINUAR I GULIVERIT								VEZË		

ZGJIDHJET: F, S, P, BOTA E RE, EF, ARIE DEMOLL, KURIOZ, RUL, KUMAR, EPIMI, RABA, FINAL, SHATE, T, ET, INK, NEUM, ATJE, SET, ATOL, SHITIM, HIPOPOTAMI, ETERRIK, LED, LILIPUT, VE,



ATA QË FALEN NË XHAMI DHE LUTEN, JANË MË TË SHËNDETSHËM!

Falja në xhami, lutjet në një kishë apo sinagogë, mund të zgjasin jetëgjatësinë, ulin nivelin tuaj të stresit dhe përmirësojnë shëndetin fizik. Kështu thotë një studim i ri nga Universiteti Vanderbilt, ku u eksperimentuan 5500 njerëz të të gjitha racave

dhe të dy gjinive. Në hulumtim thuhet se dy të tretat e tyre (64 për qind) frekuentonin rregullisht seancat e adhurimit, transmeton Klan Kosova. Po ashtu nga ky studim rezulton se pjesëmarrësit e rregullt fetar, dolën më të shëndetshëm nga zem-

ra, të ushqyerit dhe shëndeti metabolik. Ky klasifikim u pa më qartë në mesin e të rriturve të moshës mesatare 40-65 vjeç, të cilët kishin shëndet shumë më të mirë nëse morën pjesë në ceremonitë fetare, pohon studimi, transmeton Klan Kosova.



Si të dalloni një shalqi të ëmbël dhe të pjekur mirë

Sezoni i verës do të ishte i paplotë pa një prej frutave më karakteristike të verës, shalqirin. Edhe pse shumë prej jush nuk e kanë blerë akoma për këtë sezon, besoj se e keni vënë re që ai gjendet pothuaj në të gjitha stendat e tregjeve dhe marketeve. Por si gjithmonë pyetni veten a është i pjekur apo jo? Shumë prej jush mund t'i besojnë metodës klasike "shiko, provo dhe bli", por me truket e mëposhtme do të mund të zgjidhni një shalqi të ëmbël pa u lodhur shumë. Një ndër gabimet që bëjnë shumë blerës është të përzgjedhin një shalqi që duket sa më i pastër dhe me lëkurë të lëmuar. Në të vërtetë sa më e zverdhur dhe me shenja të jetë sipërfaqja, aq më i ëmbël është shalqiri. Shumë pak e dinë, por edhe shalqiri ka gjini. Pikërisht siç e lexoni, ka shalqi mashkullorë të cilët janë më të gjatë dhe në formë vezake dhe shalqi femërorë që janë të rrumbullakët. Kur të blini shalqi, hidhini një sy edhe bishtit të tij, ky detaj i parëndësishëm në pamje të parë në fakt tregon pjekurinë e frutave. Në qoftë se ai është shumë i gjelbër shalqiri është ende i papjekur, ndërsa kur është si i fishkur dhe i kafentë keni qëlluar në shenjë pasi do të hani një shalqi të ëmbël mjalhtë.

FËMIJËRI E VJEDHUR, çdo 7 sekonda në botë martohe një e mitur



Çdo 7 sekonda në botë, një vajzë me moshë më të vogël se 15 vjeçe martohe, shpesh e detyruar nga prindërit, në një martesë me një burrë shumë më të madh në moshë. Çdo vit janë rreth 15 milionë vogëlushe-nuse dhe 4 milionë prej tyre nuk i kanë mbushur 15 vjeçe. Sipas raportit të titulluar "Fëmijëri e vjedhur", e prezantuar nga shoqata 'Save The Children', Nigeria mban vendin e parë në botë me martesat e të miturave, ku 60% e vajzave me

moshë nga 15-18 vjeçe martohe. Më pas vjen Bangladeshi me 44% dhe Sudani i Jugut me 40%. Studimi shpjegon se martesat e parakohshme kanë efekt shkatërrues në jetën e vajzave të vogla, të cilat detyrohen të heqin dorë nga fëmijëria e tyre dhe nga shkolla, pasi duhet të mbajnë familjen. Vogëluset-nuse rrezikojnë edhe nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme apo të dhunës në familje, çka çon në vdekjen e shumë prej tyre.

Kur është koha më e mirë për të larë dhëmbët?

Këshilla standarde e dentistëve është që t'i lajmë dhëmbët tanë dy herë në ditë. Larja e dhëmbëve është pjesë e rutinës së mëngjesit dhe mbrëmjes, dhe disa njerëz i lajnë dhëmbët madje pas çdo ushqimi. Por, kur është koha më e mirë për të larë dhëmbët? Sipas një studimi të bërë nga hulumtuesit në Universitetin 'College' në Londër, koha më e mirë për larjen e dhëmbëve është pak konfuzë. Disa dentistë rekomandojnë që të pritni pak pasi të keni ngrënë ushqime të ndryshme ose pasi të keni pirë pije të ndryshme, kështu që të mos i dëmtoni dhëmbët. Por, dr. Richard Marques, një nga dentistët më të mirë në Britani, tha për Independent se çfarë rekomandon ai kur është fjala për larjen e dhëmbëve. "Më e mira është që t'i lani dhëmbët dy herë



në ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje, tha ai. "Duhet të pritni të paktën 30 minuta pasi të keni ngrënë ushqim për t'i larë dhëmbët, përndryshe acidi mund të dëmtojë sipërfaqen e dhëmbëve. Larja e dhëmbëve para se të shkoni për të fjetur është tepër e rëndësishme, për shkak që ushqimi i mbetur në dhëmbë mund t'i dëmtojë ata gjatë qëndrimit aty tërë natën", shtoi ai.

1598 - Franca dhe Spanja nënshkruajnë Traktatin e Paqes së Vervinit.
1808 - Kryengritje kundër okupimit francez fillon në Madrid.
1876 - Kryengritja e Prillit shpërthen në Bullgari
1885 - Formohet shteti i lirë i Kongos nga Mbreti Leopold II i Belgjikës.
1924 - Holanda refuzon të njej BRSS.
1926 - Ushtria amerikane ndërvepron në Nikaragua.
1945 - Rusia merr Berlinin. Dorëzohet Gjenerali Weidling.
1953 - Huseini I emërohet Mbret i Jordanisë.
1980 - Papa Xhon Pali II fillon turneun e tij nëpër Afrikë.
1992 - Ushtria Jugosllave kapë Kryetarin boshnjak Alia Izetbegović.
2011 - Osama bin Laden, organizatori i dyshuar i ngjarjeve të 11 shtatorit dhe njeriu më i kërkuar nga FBI është vrarë nga Forcat Speciale amerikane në Abbottabad të Pakistanit.

KALENDARI HISTORIK 2 MAJ

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS

Një studim i ri i Universitetit Norway thotë se rrobat me ngjyrë të bardhë ose me material mëndafshi duhet të pastrohen pas çdo përdorimi. Edhe bluzat me mangë të shkurtra (kanotieret) duhet të pastrohen pas çdo përdorimi.



Analizimi i rreth 200 llojeve kosi të përpunuar me shije të ndryshme, afërsisht gjysma e tyre përmbajnë tre lugë çaji sheqer për 100 gram. Dietologja Alison McAlisee thotë se kosi është i ushqyeshëm, një mesvakt i pasur me kalcium, por disa prej tyre përpunohen me shumë sheqer.



NXËNËSI PROBLEMATIK

- Ti je më problematiku i klasës! - po i thoshte mësuesja kujdestare një nxënësi.
- Pa mblidhe pak mendjen, përse të dërgojnë prindërit në shkollë?
- Edhe ata duan të kenë pak qetësi, mësuese! - thotë nxënësi.



Po të mos kishim dimër, pranvera nuk do të na shijonte kaq shumë. Po të mos provojmë ndonjëherë vështirësitë, begatia nuk do të ishte kaq e mirëpritur. (Anne Bradstreet)